USAID
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД

MANUALI PRAKTIK

PËR MENAXHIMIN DHE TRANSPARENCËN E KONTRATAVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Manuali për Menaxhimin dhe Transparencën e Kontratave të Prokurimeve Publike u hartua nga Irena Stoimenova, në kuadër të Projektit për Fuqizimin e Kapaciteteve për Shfrytëzimin e Resurseve, me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e prezantuara në këtë manual nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

PËR ÇKA SHËRBEN KY MANUAL DHE KUJT I ËSHTË DEDIKUAR? 6
1. LANIFIKIMI I PROKURIMEVE PUBLIKE.....10
1.1. Çka përfshin procesi i planifikimit të prokurimeve publike 11
1.2. Cilat probleme janë identifikuar në fazën e planifikimit përmes praktikës së deritanishme 11
1.3. Parakushtet kryesore për planifikim të suksesshëm 14
1.4. Hapat kryesorë në procesin e planifikimit 16
2. NOCIONI, LLOJET E KONTRATAVE TË PROKURIMIT PUBLIK DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE..... 26
2.1. Çka është kontrata e prokurimit publik.....27
2.2. Llojet e kontratave të prokurimit publik 27
2.3. Çka është Marrëveshja Kuadër? 29
2.4. Menaxhimi me kontratat.....31
2.5. Garancitë si mekanizëm për mbrojtjen e komunave gjatë realizimit të kontratave të prokurimit publik. 51
3. INDIKATORËT E RREZIKUT TË PROKURIMEVE PUBLIKE 54
3.1 Propozim lista e indikatorëve të rrezikut të prokurimeve publike:.....55
4. MENAXHIMI I PROJEKTEVE TË MËDHA INFRASTRUKTURORE..... 56
4.1. Fillimi i realizimit të projektit dhe zbatimi i procedurës së akordimit të kontratës 57
4.2. Procedura e akordimit të kontratës për projektin infrastrukturor konform LPP..... 58
4.3. Lidhja e kontratave sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të librave FIDIC 66
4.4. PRAG si udhëzues i procedurave për lidhjen e kontratave dhe prokurime 68
LITERATURA E PËRDORUR 72
ANEKSI 1 75
ANEKSI 2 80
ANEKSI 3 85

Lista e shkurtesave:

PVPP	plani vjetor i prokurimeve publike
AK	autoriteti kontraktor
LPP	Ligji për Prokurime Publike
OE	operatori ekonomik
SEPP	Sistemi elektronik i prokurimeve publike
BE	Bashkimi Evropian
MK	marrëveshja kuadër
DT	dokumentacioni i tenderit

PËR ÇKA SHËRBEN KY MANUAL DHE KUJT I ËSHTË DEDIKUAR?

Manuali përmban procedura standarde të operimit, të cilat duhet ta avancojnë procesin e planifikimit dhe implementimit të prokurimeve, si dhe monitorimin dhe kontrollin mbi ekzekutimin e kontratave, duke vendosur një bashkëpunim më të ngushtë midis sektorëve/seksioneve që paraqiten si kërkues, të cilët e monitorojnë realizimin e kontratave dhe Sektorit/Seksionit për Prokurime Publike, i cili i planifikon prokurimet dhe kujdeset për zbatimin ligjor të tyre.

Manuali i përfshin edhe procedurat e menaxhimit të projekteve infrastrukturore, të cilat janë të rëndësishme për përmbushjen e synimeve zhvillimore të komunës dhe njëherësh kanë pjesëmarrje më të madhe në realizimin e buxheteve komunale.

Qëllimi kryesor i manualit është t'u ndihmojë komunave në mënyrë konsekuente t'i respektojnë parimet themelore mbi të cilat mbështeten prokurimet publik, me ç'rast rolin kryesor e ka parimi i shfrytëzimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike, që në të vërtetë është "qëllimi themelor që duhet të arrihet", ndërsa të gjitha parimet e tjera janë vetëm mjete për ta arritur këtë objektiv.

➲ Parimi i shfrytëzimit efikas dhe ekonomik të mjeteve publike

Efikasiteti nënkupton në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore të ekzekutohet kontrata e prokurimit publik, që drejtpërdrejtë ndikon mbi realizimin e suksesshme të objektivave dhe kompetencave të komunës, përmbushjen e nevojave të qytetarëve dhe zbatimin e suksesshëm të mjeteve buxhetore. Nga ana tjetër, nuk duhet të lejohet rritja e paligjshme e çmimeve (përmes aneks-kontratave) në kundërshtim me Ligjin për Prokurime Publike, si dhe krijimi i shpenzimeve të panevojshme për të cilat do të duhet të sigurohen mjete shtesë publike.

Ekonomizimi nënkupton shpenzim racional të fondeve publike gjatë prokurimit të mallrave, shërbimeve ose punëve, gjë që gjithsesi arrihet duke përdorur jo vetëm çmimin, por edhe kriteret kualitative për zgjedhjen e ofertës më të favorshme në mënyrë që ta marrim vlerën më të mirë të parave, megjithatë një pjesëmarrje të konsiderueshme ka edhe vetë komuna përmes planifikimit të duhur të prokurimeve publike, duke marrë parasysh nëse nevojat janë me të vërtetë me dedikim dhe të domosdoshme për funksionimin normal të komunës

➲ Parimi i konkurrencës midis operatorëve ekonomikë

Baza e këtij parimi konsiston me sigurimin e konkurrencë sa më të madhe, përkatësisht me numrin më të madh të ofertuesve dhe ofertave të paraqitura, sepse në këtë mënyrë është e mundur të fitohen kushte më të favorshme për realizimin e kontratës, në favor të komunës. Me këtë arrihet edhe përmbushja e parimit të efikasitetit dhe ekonomizimit gjatë përdorimit të fondeve publike.

➲ Parimi i transparencës

Parimi i transparencës së procedurave të prokurimeve publike ka rëndësi të jashtëzakonshme në arritjen e qëllimeve të prokurimeve publike, ndërkaq sigurohet nga publikimi i planit të prokurimeve publike, shpalljet dhe njoftimet e këtij ligji, dokumentacioni i tenderit dhe kontrata e prokurimit publik, si dhe nga ndryshimet dhe plotësimet e tyre në SEPP.

Sa për sqarim, SEPP është i vetmi sistem informacioni i aksesshëm në internet, i cili përdoret për të mundësuar efikasitet, transparencë dhe ekonomizim më të madh në fushën e prokurimeve publike.

Në këtë kontekst, është praktikë e mirë që komunat të ndajnë këto informacione në faqen e tyre të internetit në një seksion të veçantë që do të krijohet qëllimisht për njoftimet në lidhje me prokurimet publike në përputhje me Kodin e Transparencës në nivel lokal1. Në atë seksion, komunat mund të publikojnë indikatorë e prokurimeve publike të komunës në nivel vjetor, që do të mundësojnë mbikëqyrje, nga ana e qytetarëve, të cilësisë dhe efektivitetit të prokurimeve publike të NJVL-ve.

Të gjitha këto masa duhet të sigurojnë transparencë të mjaftueshme të të dhënave të prokurimeve publike për publikun profesional dhe të gjerë, duke rezultuar në llogaridhënie dhe kontroll më të madh. Njëkohësisht, transparenca mundëson edhe verifikimin efektiv të justifikimit të prokurimit.

➲ Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë

Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë nënkupton sigurimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit publik dhe në respektim të të gjitha elementeve të ofertës. Kjo para së gjithash ka të bëjë me informacionet që ndërlidhen me procedurën e prokurimit publik, si dhe me fazën përgatitore të procedurës, përkatësisht me hartimin e planit të prokurimeve publike dhe përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, me ç'rast të njëjtat nuk mund të komunikohen në mënyrë selektive vetëm me operatorë të caktuar ekonomikë, por duhet të informohen të gjithë operatorët ekonomikë. Është veçanërisht e rëndësishme në fazën e hulumtimit të tregut kur mblidhen informacionet për hartimin e planit të prokurimeve publike dhe specifikimeve teknike, për të mbledhur informacione nga të gjithë ofertuesit potencialë që mund ta realizojnë prokurimin, pa favorizuar ofertues të caktuar. Kjo mund të arrihet duke kontrolluar informa-

1 Kodi i Transparencës në nivel lokal, Shtator 2022, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale: https://mls.gov.mk/images/files/kodeks%20za%20transparentnost%20na%20lokalno%20nivo%20konecen%20tekst%20za%20MLS.pdf

cionet e pranuara në bazë të informacioneve publikisht të aksesshme, përmes bashkëpunimit me kolegët nga komunat e tjera ose përmes institucioneve profesionale (fakultetet, p.sh.).

- **Parimi i proporcionalitetit**

Ky parim përqendrohet kryesisht mbi objektin e prokurimit dhe kërkon që objekti i prokurimit të përcaktohet në specifikimet teknike në proporcion me nevojat, përkatësisht të mos teprohet me kërkesat dhe karakteristikat teknike.

LEGJISLACIONI

Ligjet që janë të rëndësishme dhe duhet të merren parasysh në proceset e prokurimeve publike në komuna janë përshkruar më poshtë.

Ligji për Prokurime Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 24/19) – i cili e rregullon mënyrën dhe procedurat e prokurimeve publike, mbrojtjen ligjore në procedurat e prokurimeve publike, si dhe mbrojtjen ligjore në procedurat e dhënies së koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik privat.

Aktet nënligjore në fushën e prokurimeve publike:

- **Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të planit vjetor për prokurimet publike** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 64/19) – e cila përshkruan formën, përmbajtjen, si dhe mënyrën e hartimit të planit vjetor për prokurimet publike;
- **Rregullorja për llojet e aktiviteteve ndërtimore të cilat janë objekt të kontratave të prokurimeve publike** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 250/19) – përcaktohen llojet e aktiviteteve ndërtimore të cilat janë objekt të kontratave të prokurimit publik për punë.

Ligji për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 130/09) – e rregullon ndërtimin, kërkesat themelore të ndërtimit, dokumentacionin e nevojshëm të projektit për marrjen e lejes së ndërtimit, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në ndërtim, mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së ndërtimit, si dhe çështje të tjera me rëndësi për ndërtimin.

Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 18/01) - i cili rregullon bazat e marrëdhënieve detyrimore, marrëdhënieve kontraktore dhe marrëdhënieve të tjera detyrimore në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve.

Kuadri ligjor në fushën e prokurimeve publike mund të gjendet në https://www.bjn.gov.mk/

1

PLANIFIKIMI I PROKURIMEVE PUBLIKE

1.1. Çka përfshin procesi i planifikimit të prokurimeve publike

Planifikimi i prokurimeve është një nga fazat thelbësore në ciklin e prokurimeve. Vendimet që do të merren në këtë fazë në masë të madhe ndikojnë në suksesin e procedurave të prokurimeve publike, si dhe në funksionimin e suksesshëm të komunës si autoritet kontraktor.

Për më tepër, komuna duhet paraprakisht t'i përcaktojë mallrat, shërbimet ose punët që i nevojiten, periudhën kohore kur ato duhet të prokurohen, nevojën e financimit ose subvencionimit dhe cila procedurë e prokurimit publik është më e përshtatshme, duke marrë parasysh vlerën e vlerësuar dhe natyrën e objektit të prokurimit.

Së këtejmi, komuna duhet të udhëhiqet nga:

- analiza e prokurimeve dhe nevojave në periudhën e kaluar;
- nevojat aktuale dhe gjendjen e stoqeve;
- analiza e situatës aktuale të tregut;
- programi vjetor dhe zhvillimor për punën e komunës.

1.2. Cilat probleme janë identifikuar në fazën e planifikimit përmes praktikës së deritanishme

Në fazën e planifikimit të prokurimeve publike, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet **"përgatitjes në kohë të duhur të planit"** dhe **"mënyrës së planifikimit"**, sepse një nga problemet kryesore që shfaqet në praktikë është vonesa me përgatitjen e planit dhe planifikimi jo adekuat në kuptimin që planifikohet më shumë ose më pak sesa është e nevojshme. Problemi i këtillë nënkupton ose angazhimin e një sasie më të madhe të mjeteve që mbeten të papërdorura ose identifikimin në mënyrë plotësuese të nevojave të cilat nuk janë parashikuar në fazën e planifikimit, gjë që e imponon nevojën e zbatimit të procedurës së negociuar në bazë të "urgjencës" ose çon në atë që komuna të mos mundet t'i ketë në dispozicion mallrat ose shërbimet e nevojshme në momentin kur ato i nevojiten.

Praktika veç tjerash tregon se pak ose aspak vëmendje i përkushtohet çështjes së **"justifikimit"** të prokurimeve. Kështu, në specifikimin e nevojave, i cili përgatitet

nga seksioni që është përfitues i prokurimit të cilin ia dorëzon Seksionit për Prokurime Publike për hartimin e planit të prokurimeve, më së shpeshti nuk ka asnjë justifikim se nga duhet të lindë arsyeja për prokurimin në fjalë dhe se si ai prokurim kontribuon në realizimin ekonomik dhe efikas të qëllimeve të komunës, përkatësisht në realizimin e planit të saj të punës. Prandaj, është e nevojshme të vlerësohet nevoja për një prokurim të veçantë duke iu përgjigjur pyetjeve si vijojnë:

1) Cili është qëllimi dhe rezultati përfundimtar i nevojës për prokurim publik?
2) A ka mënyra të tjera për të përmbushur nevojën apo opsion i vetëm është zbatimi i prokurimit publik? A duhet të blihet, ose të merret me qira objekti i prokurimit?
3) A nevojitet sasia/vëllimi që parashikohet ose nevoja mund të kënaqet edhe me një nivel më të ulët të sasisë?
4) Cila është cilësia e duhur e objektit të prokurimit?
5) A është e nevojshme të furnizohen mallra ose shërbime që janë në dispozicion në treg ose mund të merren parasysh vetëm mallra/shërbime të përshtatura për nevojën tonë?

Pyetjet e mësipërme janë thelbësore, sepse prokurimi që nuk korrespondon me nevojat reale të komunës, prokurimi i sasive joadekuate, i cilësisë joadekuate dhe karakteristikave joadekuate, çon në përdorim joefikas të fondeve publike.

Kur bëhet fjalë për prokurime që nuk janë të domosdoshme, vëmendje e veçantë duhet t ‘i përkushtohet prokurimit të:

- Materialit shpenzues dhe pjesëve të këmbimit, të cilat komuna i posedon si stok në magazinë në sasi më të mëdha dhe për një periudhë më të gjatë nuk janë përdorur fare;
- Pajisjes që duhet të zëvendësojë pajisjet që janë ende në gjendje të mirë dhe ende mund të përdoren (automjete të reja);
- Automjeteve të terrenit, megjithëse asnjë nga aktivitetet e kryera nga komuna nuk e vë në dukje nevojën e përdorimit të një automjeti të dedikuar për terren specifik;
- Zgjidhjes softuerike jofunksionale.

Shembuj të prokurimeve në sasi dhe vëllim më të madh se nevojat janë prokurimet e:

- Sasive më të mëdha të materialit ndërtimor, megjithëse ndërtesa që do të ndërtohet ka sipërfaqe më të vogël;

- Kompjuterëve ose pjesëve të mobilieve të zyrës (tavolina pune, karrige pune, etj.) në një numër shumë më të madh se numri i të punësuarve në komunë;
- Krijimit të faqes së internetit të komunës me një numër të madh të aplikacioneve të panevojshme, që nuk do të përdoren nga vizitorët e faqes së internetit.

Sa u përket prokurimeve që në aspektin e karakteristikave cilësore dhe teknike të objektit të prokurimit devijojnë në masë të konsiderueshme nga nevojat e komunës, si shembuj mund të veçohen prokurimet e:

- Automjeteve zyrtare me fuqi motorike, dimension dhe karakteristika të tjera të panevojshme;
- Pajisjes harduerike dhe softuerike me performancë shumë të lartë (shpejtësi të lartë të procesorit, një sasi të konsiderueshme të memories në dispozicion, etj.), edhe pse furnizohen për nevojat e punonjësve të komunës të cilët ndërmarrin operacione të thjeshta dhe printojnë tekste ose shkëmbejnë e-mail;
- Telefonave zyrtarë me karakteristika të panevojshme, siç është kamera e instaluar me rezolucion të lartë;
- Mobilieve luksoze për zyrë.

Shembuj të prokurimit të objekteve me cilësi dukshëm më të ulët se cilësia e nevojshme (sepse ato janë më të lira) janë:

- Prokurimi i pjesëve të këmbimit që kanë jetëgjatësi më të shkurtër dhe që, për shkak të cilësisë së dobët, rrezikojnë të gjithë impiantin, kështu që mund të ketë defekte dhe dëme që do ta shumëfishojnë koston e pjesës së këmbimit;
- Furnizimi me goma dimri jocilësore, të cilat e pamundësojnë lëvizjen e mjeteve të patrullimit ose mjeteve të tjera të terrenit në kushte të vështira dimërore;
- Furnizimi me tonerë të cilët e pamundësojnë printimin e dokumenteve të qarta dhe të lexueshme;
- Asfaltimi i rrugëve me sasi të pamjaftueshme të asfaltit ose me asfalt me cilësi të dobët për shkak të së cilës ka dëmtime të shpeshta të karrexhatës, kështu që paraqitet nevoja për ndërhyrje të serishme në segmentet e njëjta rrugore;
- Prokurimi i pajisjes për mbrojte higjiene-teknike e cila nuk i mbron të punësuarit nga kushtet ekstreme ndaj të cilave ata janë të ekspozuar gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË:

Për të shmangur situatat e mësipërme, është mirë që komuna të posedojë akte të përcaktuara të brendshme që do të përmbajnë standarde me të cilat do të vlerësohet përse, me çfarë cilësie dhe sasie duhet të prokurohet diçka. Për shembull, standarde të këtilla mund të përcaktojë komuna për automjetet zyrtare dhe të specifikohet se mbas sa kilometrave të kaluara, ose për cilat lloje të defekteve do të fillojë procedura e prokurimit të automjeteve të reja.

Përmes planifikimit, komuna ka mundësi në kohë të duhur t'i përcaktojë të gjitha rreziqet dhe problemet potenciale që mund të shfaqen gjatë zbatimit të procedurave të prokurimeve publike dhe paraprakisht të përpilohen plane për menaxhimin dhe tejkalimin e tyre.

1.3. Parakushtet kryesore për planifikim të suksesshëm

Në mënyrë që planifikimi të jetë i suksesshëm, duhet në mënyrë konsekuente të respektohen parimet mbi të cilat bazohen prokurimet publike, si vijojnë:

- Parimi i ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të mjeteve publike;
- Parimi i konkurrencës midis operatorëve ekonomikë;
- Parimi i transparencës;
- Parimi i proporcionalitetit;

Nga ana tjetër duhet edhe respektimi konsekuent i:

- Principit të barazisë gjinore, i cili nënkupton planifikim të përgjegjshëm gjinor.

Pse është e rëndësishme të respektohet principi i barazisë gjinore në fazën e planifikimit të prokurimeve publike

Duke qenë se cikli i prokurimeve publike fillon me fazën e planifikimit, është e rëndësishme që autoriteti kontraktor, gjatë përgatitjes së planit të prokurimeve publike, ta specifikojë justifikimin e prokurimit publik. Në këtë drejtim, autoriteti kontraktor duhet, kur është e mundur, ta analizojë objektin e prokurimit në mënyrë që do t'i mundësojë atij, të perceptojë se si ndikon ai tek burrat dhe gratë.

Pyetje që duhet të parashtrohen:

- **A ka objekti i prokurimeve publike aspekt gjinor?**
- **A mban institucioni statistika gjinore?**
- **A merren parasysh, gjatë analizës së objektit të prokurimeve publike në planin e prokurimeve publike, efektet mbi burrat dhe gratë?**
- **Plani i prokurimeve publike a i specifikon në mënyrë të qartë efektet e ndryshme, të cilat objekti i prokurimit i ka mbi burrat dhe gratë?**

SHEMBULL:

Në rastin e prokurimit të çorapeve ose këpucëve për kujdestarët komunalë, është e nevojshme të sigurohen të dhëna për numrin e këpucëve të burrave dhe grave dhe të planifikohen rroba që të jenë të rehatshme dhe të përshtatshme për të dy gjinitë. Së këtejmi, mund të kërkohet provë që operatorët ekonomikë që i prodhojnë uniformat, të paguajnë rroga korrekte dhe t'i respektojnë të drejtat e njeriut dhe ligjet për marrëdhëniet e punës, veçanërisht për shkak se shpesh në kompani të tilla shumica e të punësuarve janë gra (p.sh. fabrikat e tekstilit).

Nga ana tjetër, nëse bëhet fjalë për furnizimin e punëve ndërtimore, siç është ndërtimi i një rruge, duhet të analizohet se cili do të jetë efekti i prokurimit mbi gratë dhe burrat. Zgjidhja ndërtimore a përfshin trotuare për këmbësorë (pasi që gratë vozisin më pak se burrat), a kanë trotuaret hapësira që mundësojnë qasje më të lehtë për karrocat për fëmijë, a janë mjaftueshëm të gjerë për prindërit me karroca për fëmijë, etj.

Një aspekt tjetër që duhet të merret në konsideratë ka të bëjë me atë nëse plani i furnizimeve publike është prezantuar jo vetëm publikisht, por edhe para bizneseve potenciale (zakonisht të vogla dhe të mesme) në pronësi të grave që mund të aplikojnë në thirrjet për prokurime publike dhe madje a ndihmon përmes udhëzimeve dhe trajnimeve për t'ua lehtësuar atyre bizneseve t'i kuptojnë procedurat dhe kushtet e aplikimit.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË për sigurimin e transparencës dhe barazisë gjinore:

Shpallja e thirrjes përmes faqes së internetit të komunës për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të menaxhuara nga gratë në një trajnim njëditor për t'ua sqaruar procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimeve publike.

1.4. Hapat kryesorë në procesin e planifikimit

Procesi i planifikimit përbëhet nga **6 (gjashtë) hapa kryesorë**:

Hapi 1: Aktivitetet përgatitore – analiza e tregut;


Hapi 2: Grumbullimi i nevojave të seksioneve/sektorëve që kanë rolin e kërkuesve dhe hartimi i një propozim-plani të prokurimeve publike;

Hapi 3: Përcaktimi i përmbajtjes së planit vjetor të furnizimeve publike;

Hapi 4: Miratimi i planit vjetor për furnizime publike dhe publikimi i planit në SEPP;

Hapi 5: Ndryshim/plotësimi i planit të furnizimeve publike;

Hapi 6: Monitorimi mbi realizimin e planit, krijimi i një baze të të dhënave për planifikimin dhe publikimin e ardhshëm të indikatorëve të prokurimeve publike në nivel vjetor.



HAPI 1.

AKTIVITETE PËRGATITORE – ANALIZA E TREGUT

Suksesi i planifikimit varet edhe nga analiza e realizuar e tregut, përkatësisht nga mbledhja e informacioneve të cilat mund ta ndihmojnë autoritetin kontraktor në përcaktimin e kërkesave të tij të prokurimit, në përzgjedhjen e procedurës më të përshtatshme, në përzgjedhjen e ofertave më të favorshme, si dhe në mënyrën e akordimit të kontratës. Në të vërtetë, analiza e tregut do të mundësojë:

- Të kuptohen karakteristikat e tregut, dhe në veçanti zhvillimet dhe tendencat e fundit që mund të ndikojnë mbi konkurrencën (p.sh. një numër i vogël operatorësh ekonomikë, produkte të standardizuara ose të thjeshta, pak ose aspak hyrje të ofertuesve të rinj, etj.);
- Të grumbullohen informacione për operatorët ekonomikë, produktet e tyre, çmimet ose strukturat e kostos;
- Të grumbullohen informacione për ndryshimet e fundit të çmimeve. Kjo do të mundësojë autoritetet kontraktore të jenë të informuar për çmimet në zona të caktuara gjeografike (tregje) dhe për çmimet e produkteve potenciale alternative;
- Të grumbullohen informacione për ofertat e mëparshme për të njëjtat ose për produkte të ngjashme;
- Të koordinohen me autoritetet e tjera kontraktore të cilat kohë më parë janë furnizuar me mallra, shërbime ose punë të ngjashme për ta kuptuar më mirë tregun dhe ofertuesit.

Analiza e tregut në përgjithësi duhet të përfshijë mbledhjen e informacioneve për:

- Strukturën e tregut;
- Aftësitë e OE;
- Tendencat e çmimeve.

Fushëveprimi dhe detajet e analizës së tregut ndryshojnë shumë në varësi të natyrës së prokurimit. Një analizë e thjeshtë e zyrës që realizohet për të sqaruar strukturën e tregut, për të identifikuar operatorët ekonomikë aktivë dhe për të kuptuar çmimet mund të jetë qasje adekuate në prokurimet e standardizuara të mallrave.

Në raste të tjera, analiza e tregut mund të jetë më largpamëse dhe gjithëpërfshirëse.

Analiza e tregut mund të realizohet me qëllim mbledhjen e informacioneve që mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve strategjike në lidhje me disa çështje, të tilla si nëse kërkesat e autoritetit kontraktor lejojnë që objekti i prokurimit të

ndahet në pjesë, a është e përshtatshme të përdoret marrëveshja kuadër ose një sistem dinamik blerjeje, apo nga ana tjetër a të përdoret procedura konkurruese e negociuar.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

- **Komuna ta evidentojë procesin e përgatitjes dhe zbatimit të analizës së tregut.**
- **Në fund të procesit të analizës së tregut, të hartohet një raport.**
- **Raporti paraqet një dokument transparent në të cilin janë pasqyruar çështjet e shqyrtuara, duke e përfshirë edhe evidencën e burimeve të hulumtimit dhe informacionet e shfrytëzuara, si dhe konkluzionet e analizës së tregut.**

HAPI 2.

GRUMBULLIMI I NEVOJAVE TË SEKSIONEVE/SEKTORËVE TË CILËT JANË KËRKUES DHE HARTIMI I PROPOZIM-PLANIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Në procesin e përgatitjes së propozim-planit të prokurimeve publike marrin pjesë:

- Sektori/Seksioni për Prokurime Publike që i koordinon aktivitetet;
- Sektori/Seksioni për Financat dhe Buxhetin; dhe
- Sektorët/seksionet që janë në rolin e kërkuesve.

Seksioni për Prokurime Publike e përgatit dhe dërgon pyetësorin në të gjitha njësitë organizative, më së voni deri në datën 15.09. të vitit rrjedhës për nevojat e prokurimeve publike në vitin e ardhshëm, ndërsa afati i paraqitjes së propozimeve nga sektorët/seksionet është deri në datën 01.10. të vitit rrjedhës. Rekomandohet që këto afate të respektohen në mënyrë që komuna në kohë të duhur ta hartojë propozim-planin e prokurime publike.

Pyetësori duhet t'i përmbajë informacionet si vijojnë:

- numrin rendor të objektit të furnizimit;
- llojin e objektit të prokurimit (mallra, shërbime ose punë);
- përshkrimin e objektit të prokurimit;
- sasinë dhe çmimin për copë të objektit të prokurimit sipas pjesëve dhe gjithsej;
- justifikimin për arsyeshmërinë e nevojës së prokurimit;
- prioritetin e prokurimit;

- propozimin për llojin e procedurës (mundësisht të plotësohet);
- propozimin e vlerës së vlerësuar;
- metodën e përcaktimit të vlerës së vlerësuar;
- fillimin e pritshëm të procedurës (muajin);
- datën e fillimit dhe përfundimit të realizimit të kontratës së furnizimit publik.

Në bazë të pyetësorëve të plotësuar me nevojat e artikuluara të prokurimit të njësive organizative që janë kërkuese, Seksioni/Sektori për Prokurime Publike e harton **draft planin vjetor të prokurimeve publike**. Drafti i planit vjetor të prokurimeve i dërgohet Seksionit/Sektorit për Financa dhe Buxhet, së këtejmi mbi bazën e të njëjtit dhe mbi bazën e të dhënave të tjera relevante, në bashkëpunim me Sektorin/Seksionin për Prokurime Publike, të hartohet Buxheti i komunës.

Pas miratimit të buxhetit, Sektori/Seksioni për Prokurime Publike do të hartojë **një propozim-plan vjetor të prokurimeve publike** në përputhje me buxhetin e miratuar, i cili miratohet nga udhëheqësi i Sektorit/Seksionit për Prokurime Publike dhe nga Sektori/Seksioni për Çështje Financiare, dhe i njëjti dërgohet për miratim tek personi përgjegjës ose Këshilli i Komunës, në varësi të mënyrës se si është rregulluar me statutin funksionimi i komunës.

Përpilimi i planit të prokurimeve publike është një proces participativ që duhet të harmonizohet me dokumentet e planifikimit të komunës me të cilat përcaktohen objektivat strategjikë dhe operacionalë të komunës, por edhe me draftin dhe planin e përgatitjes së kuadrit buxhetor, që i përfshin fondet/mjetet vetjake të komunës, fondet e planifikuara që mund të mbërrijnë në komunë në formën e një donacioni ose kredie, transfertën e fondeve nga pushteti qendror, si dhe të gjitha prurjet e tjera të pritshme të fondeve në komunë mbi baza të tjera.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË për transparencë më të madhe të komunës gjatë përgatitjes së PVPP

Komuna mund ta publikojë draftin e planit të prokurimeve publike dhe planin përfundimtar të prokurimeve publike në faqen zyrtare të komunës, në mënyrë që të gjitha subjektet e interesuara afariste të njoftohen me investimet e planifikuara të komunës dhe me investimet e planifikuara në komunitetin lokal dhe të njëjtat të kontribuojnë në përmirësimin e përmbajtjes së saj përmes komenteve, propozimeve ose vërejtjeve, për të cilat do të caktohet një afat i arsyeshëm.

SHEMBULL i hartimit të planit vjetor të prokurimeve publike me një axhendë të aktiviteteve

Afati	Bartësi i aktivitetit	Aktiviteti
shtator	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike	Paraqitja e kërkesës për grumbullimin e nevojave të të gjithë sektorëve/ seksioneve për hartimin e planit të prokurimeve në përputhje me propozim buxhetin.
shtator/tetor	Të gjithë sektorët/ seksionet	Unifikimi i nevojave brenda sektorëve/ seksioneve për hartimin e draft-planit për prokurime, në përputhje me propozim-buxhetin.
tetor	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike Sektori/Seksioni për Financat dhe Buxhetin	Analiza e nevojave të mbledhura, verifikimi i përputhshmërisë me propozim-buxhetin dhe unifikimi i nevojave, si dhe aprovimi nga Sektori i Financave - korrigjime të mundshme.
nëntor	Të gjithë sektorët/ seksionet	Përgatitja e propozim-planeve të prokurimit sipas sektorëve/seksioneve në përputhje me aprovimin ose korrigjimet e Sektorit të Financave.
nëntor/dhjetor	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike	Përgatitja e propozim-planit të prokurimit të komunës si një përmbledhje të propozim-planeve të prokurimit të sektorëve/seksioneve individuale.
janar	Personi përgjegjës/ Këshilli i Komunës	Miratimi i planit vjetor të prokurimeve publike.
janar (deri më 31 janar)	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike	Publikimi i planit vjetor të prokurimeve publike në SEPP.
shkurt	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike	Publikimi i indikatorëve të PP nga viti paraprak.
gjatë vitit	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike Të gjithë sektorët/ seksionet	Zbatimi i procedurave të prokurimeve publike.
gjatë vitit	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike	Publikimi i njoftimeve për kontratat e lidhura dhe të realizuara të prokurimit publik/marrëveshja kuadër.
gjatë vitit	Sektori/Seksioni për Prokurime Publike Sektori/Seksioni për Financat dhe Buxhetin Të gjithë sektorët/ seksionet	Monitorimi dhe zbatimi i planit.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

- Përgatitja e draft planit të prokurimeve publike duhet të fillojë paralelisht me përgatitjen e buxhetit për vitin e ardhshëm.
- Komuna mund të organizojë takime konsultative me sektorin e biznesit pas publikimit të draft planit të prokurimeve publike, në mënyrë që të tregojë transparencë më të madhe.
- Kur planifikoni prokurimet, merrni parasysh të gjithë faktorët që lidhen me objektin e prokurimit që kanë ose do të kenë ndikim mbi rritjen e shpenzimeve, përkatësisht mbi vlerën e prokurimit (p.sh. shpenzimet e udhëtimit, angazhimi i stafit profesional, mirëmbajtja, servisimi, magazinimi, sigurimi i pjesëve të këmbimit, menaxhimi i mbetjeve, shpenzimet e energjisë elektrike, etj.), veçanërisht nëse këto shpenzime përcaktohen si pjesë e kriterit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme – shpenzimet e afatit të shfrytëzimit.

HAPI 3.

PËRCAKTIMI I PËRMBAJTJES SË PLANIT VJETOR TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Komuna, si autoritet kontraktor, e ka detyrimin ligjor të përpilojë një plan vjetor për nevojat e përgjithshme të prokurimit, sipas llojit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si dhe për secilin prokurim ta përcaktojë:

- shifrën sipas Listës së përbashkët të nocioneve të prokurimeve publike;
- llojin e kontratës - mallrave, shërbimeve ose punëve;
- fillimin e pritshëm të procedurës;
- vlerën e vlerësuar të kontratës; dhe
- llojin e procedurës së prokurimit publik.

Përveç kësaj që u tha më lart, komuna duhet në planin t'i parashikojë nevojat e saj që planifikon t'i realizojë si prokurim grupor ose nëpërmjet një organi qendror të prokurimit, si dhe prokurimet e shërbimeve të veçanta.

VINI RE! Gjatë planifikimit të prokurimeve grupore, në planin vjetor të prokurimeve publike, vlerën e vlerësuar komuna e inkorporon vetëm në prokurimin e vet.

Kontratat e prokurimeve publike që do të realizohen për më shumë se një vit, gjithashtu, inkorporohen në planin vjetor të prokurimeve publike, edhe atë në planin për vitin kur është planifikuar të zbatohet procedura e prokurimeve publike.

Ky plan duhet të jetë brenda kornizës dhe i njëjtë me fondet e siguruara të prokurimit, të cilat lëvizin brenda kufijve të buxhetit, përkatësisht brenda planit financiar dhe programit të investimeve.

Cilat prokurime nuk inkorporohen në planin vjetor të prokurimeve publike

Në planin vjetor të prokurimeve publike **nuk duhet** të inkorporohen:

- Procedurat e negocimit pa publikimin e shpalljes së prokurimit publik për mallra, shërbime ose punë që i përfshijnë rastet si vijojnë:
  - kur për dy procedura të hapura paraprakisht të zbatuara ose për procedura të hapura të thjeshta nuk është paraqitur asnjë ofertë ose asnjë ofertë e përshtatshme, me kusht që kushtet e dokumentacionit të tenderit të mos kenë pësuar ndryshime në masë të konsiderueshme;
  - nëse për shkak të urgjencës ekstreme, të shkaktuar si rezultat i ngjarjeve të cilat autoriteti kontraktor nuk mund t'i parashikonte, afatet për procedurat e tjera nuk mund të aplikohen (p.sh. pandemia, fatkeqësitë natyrore, etj.);
- Procedurat e negocimit pa publikimin e shpalljes së prokurimit për mallra që i përfshijnë rastet si vijojnë:
  - kur autoriteti kontraktor doemos duhet të furnizojë prokurime shtesë nga bartësi fillestar i prokurimit për shkak të shkëmbimit të pjesshëm të mallrave ose instalacioneve të zakonshme ose zmadhimit të mallrave ose instalacioneve ekzistuese, me ç'rast kohëzgjatja e prokurimeve shtesë nuk guxon të kalojë tre vjet nga lidhja e kontratës fillestare, ndërsa vlera e tyre nuk guxon të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare; dhe
  - fakti që prokurohen me kushte veçanërisht të favorshme nga një ofertues i cili i mbyll aktivitetet e tij afariste (likuidim ose falimentim);

(Procedurat e tjera përmes negocimit pa publikimin e shpalljes duhet të planifikohen në planin vjetor të prokurimeve publike).

- Procedurat që përsëriten për shkak të anulimit të pjesëve në procedurën paraprake, gjithashtu, nuk duhet të inkorporohen në planin vjetor të prokurimeve publike;

- Prokurimet në sektorin publik klasik nën 1000 euro në kundërvlerë në denarë për mallra ose shërbime ose për një konkurs për zgjedhjen e zgjidhjes ideore, nën 5,000 euro në kundërvlerë në denarë për punë edhe nën 10,000 euro në kundërvlerë në denarë për shërbime të veçanta.

SHËNIM: Forma, përmbajtja dhe mënyra e hartimit të planit vjetor për prokurime publike përcaktohet me Rregulloren për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të PVPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 64/19), e cila mund të shkarkohet nga linku në vijim: (https://www.bjn.gov.mk/podzakonski-akti-zjn/pravilnik-za-godisen-plan-za-javni-nabavki/)

HAPI 4.

MIRATIMI DHE PUBLIKIMI I PLANIT VJETOR TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Komuna e miraton dhe publikon planin e prokurimeve publike në SEPP më së voni deri në datë 31 janar të vitit rrjedhës.

Planin vjetor e miraton personi përgjegjës i autoritetit kompetent për vendim-marrje lidhur me shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve. Se kush e miraton planin varet nga mënyra se si është rregulluar në statutin dhe në aktet e tjera normative që e rregullojnë funksionimin e autoritetit.

Në rastin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, planin vjetor të prokurimeve publike mund ta miratojë dhe nxjerrë Këshilli i Komunës – që është një praktikë veçanërisht e mirë dhe një hap i domosdoshëm në kontekstin e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe.

Pas miratimit të planit vjetor të prokurimeve publike, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i parimit të transparencës, komuna e ka për detyrë ta publikojë planin në SEPP jo më vonë se data 31 janar e vitit rrjedhës. Në këtë mënyrë, plani i prokurimeve publike bëhet publikisht i aksesshëm për të gjitha subjektet e interesuara në linkun si vijon:

(https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx#/annual-plans)

HAPI 5.

NDRYSHIMI/PLOTËSIMI I PLANIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Duke qenë se plani vjetor është një projeksion orientues i nevojave vjetore të cilat gjatë vitit mund të ndryshojnë, nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor gjatë vitit mund ta ndryshojë dhe/ose plotësojë planin, në përputhje me fondet e planifikuara ose të siguruara për prokurimet publike.

Plani vjetor i prokurimeve publike **nuk duhet** të ndryshohet kur ndryshohet vlera e vlerësuar, kur ndryshohet lloji i procedurës së prokurimit publik ose kur ndryshon fillimi i pritshëm i procedurës. Në këtë rast, mjafton të vendosni një shënim të shkurtër për llojin e ndryshimit në kolonën "Vërejtje" në planin.

VINI RE! Procedurat që përsëriten për shkak të anulimit të pjesëve në procedurë paraprake, nuk duhet të inkorporohen në planin vjetor të prokurimeve publike.

Respektimi i parimit të transparencës gjatë ndryshimit/plotësimit të PPP

Komuna e ka detyrimin ligjor të publikojë çdo ndryshim në planin e prokurimeve publike në SEPP, me ç'rast njëkohësisht sigurohet edhe respektimi i parimit të transparencës.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

Për të siguruar transparencë më të madhe, është mirë që Komuna të publikojë çdo ndryshim në planin e prokurimit publik në faqen e saj të internetit, në seksionin e parashikuar për informacione në lidhje me prokurimet publike.

HAPI 6.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT DHE KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR PLANIFIKIMIN E ARDHSHËM

Pas miratimit të planit vjetor të prokurimeve, Sektori/Seksioni për Prokurime Publike ua dërgon planin të gjithë sektorëve/seksioneve me ç'rast do të njoftohen me përmbajtjen e tij, në formë të shkruar ose në formë elektronike. Duke vepruar kështu, në shkresë theksohet nevoja për monitorimin e rregullt të afateve, përkatësisht dinamika e zbatimit të planit dhe paraqitja në kohë të duhur të kërkesave për nisjen e procedurave të prokurimit publik.

Përmes monitorimit të rregullt të realizimit të planit grumbullohen të dhënat e përqindjes së realizimit të planit në fjalë, shumës së kontratave të lidhura dhe përcaktimi i dallimit sa i përket vlerës së vlerësuar, cilat prokurime nuk janë realizuar, me cilat prokurime është plotësuar plani dhe ngjashëm. Bazuar në të gjitha këto të dhëna, komuna krijon bazën e të dhënave që do të përdoret si bazament për planifikimin e ardhshëm.

Si mundet komuna ta rrisë transparencën gjatë punës përmes të dhënave të fituara nga monitorimi i realizimit të PPP?

Rekomandohet që komunat të ndërmarrin aktivitete për të vënë në dispozicion të publikut informacionin lidhur me realizimin e PPP.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË për transparencë më të madhe

Sektori/Seksioni për Prokurime Publike mund të publikojë raporte tremujore për përqindjen e zbatimit të planit në faqen e internetit të Komunës me përmbajtjen si vijon:

- numri i procedurave të planifikuara;
- numri i procedurave të zbatuara;
- sa procedura nuk kanë filluar dhe cila është arsyeja për këtë;
- vlera e kontratave të lidhura dhe diferenca e realizuar midis mjeteve të planifikuara dhe vlerës së kontratës së lidhur;
- statistika gjinore, respektivisht të dhënat që kanë të bëjnë p.sh. me numrin e kontratave të lidhura me kompanitë në pronësi të grave.

Në fund të vitit, indikatorët e prokurimeve publike publikohen në nivel vjetor për vitin paraprak.

Planifikimi si funksion i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale duhet të përmirësohet vazhdimisht, duke i identifikuar mangësitë dhe dobësitë e viteve të mëparshme dhe duke u përpjekur për t'i kapërcyer ato në vitin e ardhshëm.

2

NOCIONI, LLOJET E KONTRATAVE TË PROKURIMIT PUBLIK DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE

2.1. Çka është kontrata e prokurimit publik

Kontrata e prokurimit publik është një kontratë me interes financiar e lidhur me shkrim ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, objekti i së cilës është furnizimi me mallra, ofrimi i shërbimeve ose kryerja e punëve ndërtimore.

2.2. Llojet e kontratave të prokurimit publik

Duke pasur parasysh se objekt i një kontrate të prokurimit publik mund të jetë livrimi i mallrave, sigurimi i shërbimeve ose kryerja e punëve, ekzistojnë tri lloje të kontratave të prokurimit publik, si vijon:

- kontrata e prokurimit publik të mallrave;
- kontrata e prokurimit publik të shërbimeve; dhe
- kontrata e prokurimit publik të punëve.

Është e rëndësishme të bëhet diferenca midis procedurës së prokurimit publik të punëve dhe procedurës së prokurimit publik të mallrave dhe shërbimeve, sepse për punët ndërtimore ligji parashikon pragje dukshëm më të larta të vlerës për zbatimin e procedurave përkatëse.

➲ Kontrata e prokurimit publik të mallrave

Objekti i kontratës së prokurimit publik për mallrat është prokurimi i një ose më shumë mallrave, nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme::

- blerjes së menjëhershme;
- blerjes me pagesë të prolonguar ose;
- qiramarrjes me ose pa opsionin për blerjen e mallit.

Kontrata për prokurimin publik të mallrave mund të përfshijë edhe shërbime për instalimin dhe inkorporimin e tyre.

➲ Kontrata e prokurimit publik të shërbimeve

Objekti i kontratës së prokurimit publik është prokurimi i shërbimeve, përveç atyre të cilat në vijim janë specifikuar si punë.

➲ Kontrata e prokurimit publik të punëve

Objekti i kontratës së prokurimit publik të punëve nënkupton:

a) kryerje ose projektim dhe kryerje të punimeve që lidhen me një ose më shumë aktivitete ndërtimi;

b) kryerje të ndërtimit ose projektim dhe kryerje të ndërtimit; dhe

c) realizim të ndërtimit me të gjitha llojet e mjeteve, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, i cili ka ndikim vendimtar sa i përket llojit ose projektimit të ndërtimit.

Së këtejmi, kontratë e prokurimit publik të punëve është ajo kontratë, përkatësisht ajo procedurë që përfshin vetëm kryerjen e punëve ndërtimore (ose të ndërtimit) ose përfshin projektimin dhe kryerjen e punëve ndërtimore (ose të ndërtimit). Në rastin e parë, fillimisht prokurohen shërbimet për projektimin e projekti bazë, dhe më pas në një procedurë tjetër përzgjidhet kontraktori i punëve, me ç'rast projektimi konsiderohet si kontratë e prokurimit publik të shërbimeve, por jo edhe të punëve. Në rastin e dytë, projektimi përfshihet në objektin e kontratës së prokurimit publik të punëve, pasi prokurohet në një paketë të vetme, sipas principit "me çelës në dorë".

REKOMANDIM PËR PRAKTIKË TË MIRË

- **Nëse bëhet fjalë për një prokurim të kombinuar të mallrave dhe shërbimeve, konsiderohet se kontrata është një kontratë e prokurimit publik për mallra nëse mallrat kanë pjesëmarrje më të madhe në vlerën e vlerësuar të shërbimeve, përndryshe konsiderohet se kontrata është një kontratë e prokurimit publik të shërbimeve.**
- **Në rast se ekziston dilemë nëse objekt i prokurimit janë shërbimet ose punimet, do të ishte mirë të verifikohet nëse objekti i prokurimit është përfshirë me Rregulloren për llojet e aktiviteteve ndërtimore që janë objekt i kontratave të prokurimeve publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 250/19) e cila është në dispozicion në linkun e mëposhtëm: https://www.bjn.gov.mk/podzakonski-akti-zjn/pravilnik-za-vidovite-na-gradezhni-aktivnosti/ , dhe nëse nuk është përfshirë me këtë Rregullore, atëherë bëhet fjalë për shërbim.**

Si trajtohen kontratat kur prokurimi është i ndashëm?

Nëse objekti i një kontrate të prokurimit publik formohet në disa pjesë të veçanta, atëherë për secilën pjesë mund të lidhet kontratë e veçantë.

SHEMBULL:

Nëse komuna zbaton një prokurim publik të njëjtë për kryerjen e punëve ndërtimore dhe kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe e ndan atë në dy pjesë, përkatësisht PJESA 1 është kryerja e punëve ndërtimore, dhe PJESA 2 është kryerja e mbikëqyrjes profesionale, pas përfundimit të procedurës së prokurimit publik, komuna do të lidhë kontrata të veçanta për secilën pjesë, përkatësisht një kontratë për kryerjen e punëve ndërtimore me ofertuesin më të favorshëm të përzgjedhur për PJESËN 1 dhe një kontratë të dytë për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale me ofertuesin më të favorshëm për PJESËN 2.

2.3. Çka është marrëveshja kuadër?

Marrëveshja kuadër është një mënyrë e veçantë e akordimit të kontratës së prokurimit publik, duke zbatuar ndonjë nga procedurat e rregullta të parashikuara me ligj dhe është një marrëveshje midis një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë me kohëzgjatje të kufizuar, e cila përcakton kornizën për akordimin e kontratave individuale të prokurimit publik që do të akordohen brenda asaj periudhe kohore, veçanërisht për sa i përket çmimit dhe, nëse është e mundur, sasive të parashikuara.

Marrëveshja kuadër vetvetiu nuk përbën kontratë dhe nuk krijon detyrim për komunën të kërkojë që mallrat, shërbimet ose punët (objekti i marrëveshjes) të livrohen ose të kryhen. Marrëveshja nënkuptohet si një mundësi për komunën në momentin kur do t'i duhet diçka që është objekt i marrëveshjes për t 'iu qasur njërës prej palëve dhe me të njëjtën të lidhë një kontratë livrimi, përkatësish kontratë realizimi të asaj që është objekt i marrëveshjes, sipas kushteve të përcaktuara në të njëjtën.

Marrëveshja kuadër **kontraktohet më shpesh** nëse:

- objekt i kontratës së prokurimit publik janë shërbime ose mallra për konsum të gjerë;
- nuk dihet koha dhe sasia e saktë që do t 'i duhet autoritetit kontraktor (mirëmbajtja e vazhdueshme e objekteve, punë ndërtimore-zejtare, etj.);
- objekti i nënshtrohet mirëmbajtjes dhe servisimit permanent (p.sh. mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve, pajisja zjarrfikëse, etj.);
- çmimi dhe kushtet e livrimit të objektit ndryshojnë vazhdimisht (p.sh. furnizimi me energji elektrike); dhe
- ekziston mundësia që brenda një periudhe të caktuar kohore të ketë nevojë për akordimin e serishëm të kontratës së prokurimit publik për të njëjtin objekt të prokurimit.

Duke lidhur një marrëveshje kuadër, autoriteti kontraktor do të kursejë kohë dhe do të zvogëlojë shpenzimet e zbatimit të serishëm të procedurës për akordimin e kontratës së prokurimit publik.

Marrëveshja kuadër mund të lidhet për një periudhë kohore deri në tre vjet.

SHËNIM: Para përcaktimit të kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, duhet të merret parasysh madhësia e tregut për të mos kufizuar dhe çrregulluar konkurrenca, si dhe specifikat e objektit të prokurimit, me fjalë të tjera me kalimin e kohës a do të ketë tendencë për të ulur çmimet dhe ngjashëm.

Përparësitë kryesore të marrëveshjes kuadër janë si më poshtë::

- Kursimet bëhen për sa i përket shpenzimeve dhe kohës së nevojshme për zbatimin e shpeshtë të procedurave për objektin e njëjtë të prokurimit;
- Ekonomia e vëllimit;
- Porosi sapo të shfaqet nevoja;
- Konkurrenca e përhershme midis ofertuesve të përzgjedhur të aftë gjatë akordimit të mini tenderëve;
- Ato mund të kombinohen lehtësisht dhe të përdoren për prokurimin në grup.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

Prokurimi në grup mund të zbatohet për nevojat e organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe shërbimeve publike, themeluesi i të cilave është Vetëqeverisja Lokale. Për më tepër, me akt të veçantë do të përcaktohet se cili autoritet kontraktor do ta zbatojë procedurën e prokurimit publik duke kontraktuar një marrëveshje kuadër me një ose më shumë ofertues, për shembull për rikonstruksionin e shkollave në territorin e komunës, prokurimin e shërbimeve të telefonisë celulare dhe ngjashëm.

Përveç kësaj, mund të zbatohet edhe një prokurim në grup që do të përfundojë me lidhjen e një marrëveshjeje kuadër për mirëmbajtjen e rrugëve që do të realizohet midis disa komunave fqinje.

Gjatë vlerësimit të vlerës së marrëveshjes kuadër, duhet të merret parasysh vlera maksimale e vlerësuar e të gjitha kontratave individuale të parashikuara që planifikohen të akordohen për kohëzgjatjen e përgjithshme të marrëveshjes kuadër.

Përmbajtja e marrëveshjes kuadër nuk është specifikuar, por zakonisht i përmban informacionet si vijojnë:

- kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër;
- objekti i prokurimit;
- kushtet që do të vlejnë gjatë akordimit të kontratave individuale;
- mënyra në të cilën do të akordohen kontratat individuale;
- kriteri për zgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm.

Kontratat individuale të cilat akordohen në bazë të marrëveshjes kuadër të kontraktuar duhet të akordohen para skadimit të afatit për të cilin është lidhur marrëveshja.

Kur akordohen kontrata individuale, kushtet bazë të përcaktuara paraprakisht në marrëveshjen kuadër nuk guxon të ndryshohen.

Sa i përket numrit të operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet marrëveshja kuadër, ekzistojnë dy lloje të marrëveshjeve kuadër:

- Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik (kontratat individuale akordohen në përputhje me kushtet e marrëveshjes kuadër);
- Marrëveshje kuadër me më shumë operatorë ekonomikë (kontratat individuale akordohen: a) pa grumbullimin e serishëm të ofertave (sistemi kaskadë) ose b) me grumbullimin e serishëm (mini tenderë).

2.4. Menaxhimi me kontratat

Menaxhimi i kontratës është faza përfundimtare e procedurës së prokurimit ndërkaq ka të bëjë me periudhën nga lidhja (firmosja) e kontratës deri në përfundimin e saj.

Menaxhimi i kontratave përbëhet nga **5 (pesë) hapa kryesorë**.

Hapi 1: Lidhja e kontratës për prokurimin publik/marrëveshja kuadër;

Hapi 2: Ekzekutimi dhe kontrolli i kontratës;

Hapi 3: Ndryshimi i kontratës gjatë vlefshmërisë së saj;

Hapi 4: Përfundimi i kontratës;

Hapi 5: Prishja e kontratës së prokurimit publik.

HAPI 1.

LIDHJA E KONTRATËS SË PROKURIMIT PUBLIK/MARRËVESHJA KUADËR

Procedura e prokurimit publik, nëse zbatohet me sukses, përfundon me lidhjen e kontratës së prokurimit publik ndërmjet komunës dhe ofertuesit më të favorshëm të përzgjedhur.

Përmbajtja e kontratës përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, kryerja e të cilave shpie në rezultatin e dëshiruar të prokurimit publik, respektivisht livrimin e mallrave, sigurimin e shërbimeve, kryerjen e punëve.

Rregullat themelore që duhen marrë parasysh gjatë lidhjes së kontratës së prokurimit publik

- Kontrata ose marrëveshja kuadër do të lidhet me shkrim brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës më të favorshme, por jo më vonë se 30 ditë nga dita e përfundimit të vendimit për zgjedhjen.
- Në përmbushje të detyrimeve kontraktore, palët kontraktore, përveç dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike, duhet të zbatojnë në mënyrë adekuate edhe dispozitat e ligjit që i rregullon marrëdhëniet detyrimore, si dhe aktet normative materiale me të cilat rregullohet objekti i prokurimit.
- Kontrata e lidhur duhet të përputhet me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe me ofertën e ofertuesit të përzgjedhur.
- Ndryshimi i kushteve të DT dhe ofertës në kontratën e prokurimit publik është shkelje e Ligjit për Prokurime Publike.
- Kontrata e prokurimit publik nuk guxon të lidhet në një vlerë më të ulët ose më të lartë nga vlera e ofertës më të favorshme të përzgjedhur.
- Pjesët përbërëse të kontratës janë oferta, specifikimet teknike/objekti i dokumentacionit të tenderit, përkatësisht detyra e projektit, katalogët/prospektet dhe garancia bankare për kryerjen në kohë dhe me cilësi të kontratës (nëse parashikohet në DT).
- Nëse marrëveshja kuadër lidhet me disa operatorë ekonomikë, mund të lidhet një marrëveshje me të gjithë operatorët ekonomikë të përzgjedhur ose marrëveshje kuadër individuale me secilin prej operatorëve ekonomikë të përzgjedhur individualisht.
- Kontrata e prokurimit publik nënshkruhet nga personi përgjegjës.
- Kontrata e kontraktuar e prokurimit publik është e vlefshme deri në realizimin e plotë të kontratës (në aspektin kohor, të vlerës ose sasisë).

- Brenda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës, detyrimisht publikohet "Njoftimi për lidhjen e kontratës në SEPP" (https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx#/njoftimet-for-acpp), duke ia bashkëngjitur kopjen e kontratës të kompletuar me ofertë teknike, me listën e çmimeve dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, me synimin që të respektohet në mënyrë konsekuente parimi i transparencës.
- Në rastin e një marrëveshjeje kuadër, njoftimi për lidhjen e kontratës për kontratat individuale publikohet në mënyrë përmbledhëse për të gjitha kontratat individuale të lidhura në tre muajt e fundit në bazë të marrëveshjes kuadër, brenda dhjetë ditëve pas përfundimit të çdo tremujori.

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA

- **Të përdoret model i kontratës në përbërje të dokumentacionit të tenderit, në mënyrë që operatorët potencialë ekonomikë të informohen në kohë të duhur në lidhje me përmbajtjen dhe kushtet e kontratës.**
- **Pas hartimit të kontratës nga Sektori/Seksioni për Prokurime Publike, e njëjta duhet të kontrollohet nga sektori në fushëveprimin e të cilit është furnizimi publik në fjalë, si dhe të verifikohet nga bartësi i zgjedhur i prokurimit, me synimin që në mënyrë konsekuente të respektohet parimi i transparencës.**

Përmbajtja e kontratës së prokurimit publik/marrëveshjes kuadër

Zakonisht kontrata e prokurimit publik i përmban këto elemente:

- palët kontraktore;
- objektin e kontratës;
- vlerën e përgjithshme të kontratës;
- kohëzgjatjen e kontratës;
- dinamikën e livrimit të mallrave, të shërbimeve ose punëve;
- mënyrën, kushtet dhe afatet e pagesës;
- kamatëvonesën për pagesat e vonuara;
- diferencat e çmimeve;
- garancinë për zbatimin e kontratës dhe kushtet e pagesës;
- dënimin/penalitetin kontraktor për vonesën ose mospërmbushjen e kontratës;

- mënyrën e realizimit të pranimit kuantitativ dhe kualitativ;
- mënyrën e pranim-dorëzimit të mallrave, kryerjen e shërbimeve dhe punëve;
- kushtet për modifikimin e kontratës gjatë vlefshmërisë së saj;
- forcën madhore;
- sigurimet;
- periudhën e garancisë;
- servisimin;
- trajnimin;
- dëmshpërblimet;
- kushtet e ndërprerjes dhe prishjes së kontratës; dhe
- zgjidhjen e kontesteve.

Parashikimi i kushteve të veçanta

Palët kontraktore mund të parashikojnë kushte të veçanta për ekzekutimin e kontratës, të cilat kanë të bëjnë me respektimin e barazisë midis grave dhe burrave.

SHEMBULL I KUSHTIT TË VEÇANTË

- **Është e mundur në kontratë të përfshihen kërkesat që një pjesë e stafit ose personave profesionalë që janë përgjegjës për kryerjen e shërbimeve ose punëve të kontratës të jenë të seksit më pak të përfaqësuar ose të përshtaten kushtet e punës për seksin i cili është më pak e përfaqësuar.**
- **Sipas kësaj, mund të parashikohet kërkesa si vijon: në hartimin e projektit bazë ose në kryerjen e mbikëqyrjes ose gjatë kryerjes së punëve, së paku 30% e inxhinierëve të ekipit menaxhues të jenë gra.**

HAPI 2.

EKZEKUTIMI DHE KONTROLLI I KONTRATËS

Kontrata ose marrëveshja kuadër do të ekzekutohet nga palët kontraktore në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën më të favorshme të përzgjedhur.

Komuna është e detyruar **të ushtrojë kontroll** nëse ekzekutimi i kontratës së prokurimit publik ose marrëveshjes kuadër është në përputhje me kushtet e kontratës. Kjo do të thotë se realizimi i kontratës nuk duhet të merret si i mirëqenë, por duhet të menaxhohet (monitorohet) për të siguruar përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Ka disa arsye pse kontratat dhe marrëveshjet kuadër duhet të monitorohen, p.sh. kompleksiteti i tyre, kohëzgjatja dhe vlera e tyre, nevoja për të përfshirë më shumë subjekte dhe resurse gjatë realizimit të tyre dhe nevoja që komuna të sigurojë se paratë publike shpenzohen në mënyrë efikase dhe efektive.

Kontrolli mbi ekzekutimin e kontratës i përfshin aktivitetet e mëposhtme:

- menaxhimi i marrëdhënieve;
- menaxhimi i livrimit, kuadrit kohor, rreziqeve, mbajtjes së shënimeve.

➲ Menaxhimi i marrëdhënieve

Gjatë ekzekutimit të kontratës, **palët kontraktore duhet të ndërtojnë dhe mbajnë një marrëdhënie të hapur dhe konstruktive**. Komunikimi i rregullt dhe pa pengesa do të mundësojë shkëmbimin e njohurive, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe aftësi më të mëdha për të parashikuar problemet ose rreziqet e mundshme.

Është në interes të komunës që kjo marrëdhënie të funksionojë, sepse shpenzimet e prishjes së parakohshme dhe pasojat e realizimit të dobët, ndryshimit të paplanifikuar të bartësit të prokurimit mund të sjellin dëme të mëdha.

Për krijimin dhe mbajtjen e një marrëdhënie të mirë me bartësin e prokurimit, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë **takime të rregullta** gjatë gjithë procesit, dhe veçanërisht në fillim të zbatimit të kontratës.

Çdo herë duhet të mbahet **një mbledhje preliminare** në fillim të zbatimit të kontratës. Ky duhet të jetë një takim me prezencë fizike ku do të marrin pjesë përfaqësuesit e dy palëve kontraktore të përfshira në realizimin e kontratës.

Ky takim ka qëllim të dyfishtë:

- Njohja me njëri-tjetrin dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive kryesore;
- Harmonizimi i kuptimit të përbashkët të kontekstit dhe objektivave të kontratës dhe mënyrave të propozuara për arritjen e tyre dhe, përfundimisht, përmbushja e nevojave të komunës.

Komunikimi i vazhdueshëm dhe i rregullt është i nevojshëm gjatë zbatimit të kontratës, duke përfshirë përcaktimin e formave dhe kanaleve për adresimin e informacioneve dhe takimeve për vlerësimin e rezultatet, në mënyrë që të zhvillohet besimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë dhe të sigurohet një qasje e përbashkët për arritjen e objektivave të kontratës.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

ДTë dyja palët kontraktore duhet të caktojnë persona që do të jenë drejtpërdrejtë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke u kujdesur që ata të jenë kompetentë në fushën të cilën e mbulon kontrata e prokurimit publik.

➲ Menaxhimi i livrimit, kuadrit kohor, rreziqeve dhe mbajtjes së evidencës

Tabela në vijim i pasqyron mekanizmat e zakonshëm dhe të thjeshtë për menaxhimin e livrimit, kuadrit kohor, rreziqeve dhe mbajtjes së evidencës, me qëllim kursimin e kohës dhe shmangien e vështirësive gjatë realizimit të kontratave.

Mekanizmi/ teknika	Përshkrimi	Zbatueshmëria mbi
Takimi preliminar	Takimi me praninë fizike të përfaqësuesve kryesorë nga të dyja palët kontraktore të ngarkuara për monitorimin e realizimit të kontratës, në të cilën mund: • të ndërtohet besimi ndërmjet palëve; • të arrihet një mirëkuptim i përbashkët për objektin dhe shtrirjen e kontratës; • ta ndihmojë bartësin e prokurimit për të kuptuar pritshmëritë dhe objektivat bazë; • të përcaktohet një plan pune; • të planifikohen komunikime më të shpeshta, raportet e progresit dhe takimet e vlerësimit të performancës.	Të gjitha kontratat
Raportet e progresit	Njoftimi në kohë të duhur dhe konciz i progresit dhe arritjet në lidhje me planin e punës.	Të gjitha kontratat
Mbikëqyrja gjatë realizmit (p.sh. gjatë takimeve të rregullta për vlerësimin e rezultateve)	Mbikëqyrja e kryer nga autoriteti kontraktor në lidhje me livrimet e realizuara dhe/ose periodike, mundëson: • të përshtatet kuadri kohor nëse është e nevojshme; • të konfirmohen përshtatjet e vogla gjatë realizimit; • të propozohen rekomandime; • të realizohen pagesa të ndërmjetme.	Të gjitha kontratat
Shënime për problemet	Mekanizmi i raportimit të problemeve gjatë realizimit të kontratës dhe zgjidhja e tyre. Problemet evidentohen ashtu siç shfaqen, bashkë me masat e marra për zgjidhjen e tyre.	Kontratat komplekse (p.sh. kryerja e punëve ndërtimore dhe shfaqja e rrethanave të paparashikuara)
Pasqyra e pikave kryesore	Procedura e kontrollit të cilën autoritetet kontraktore mund ta përdorin për t'u siguruar se aktivitetet në secilën fazë të zbatimit kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme, para se ta japin pëlqimin për të kaluar në fazën tjetër.	Kontratat komplekse (p.sh. përpilimi i një studimi mbi justifikimin e rikonstruksionit të ndriçimit rrugor përmes zëvendësimit të llambave të natriumit me llamba LED)
Menaxhimi i rreziqeve	Identifikimi, analiza dhe monitorimi i të gjitha llojeve të rreziqeve gjatë realizimit të kontratës. Pavarësisht nga kompleksiteti i kontratës, autoritetet kontraktore duhet të bëjnë një vlerësim të rrezikut qysh në fazën e planifikimit të prokurimit në mënyrë që t'i identifikojnë rreziqet potenciale dhe të përcaktojnë masa për zbutjen e tyre. Përveç kësaj, duhet të kërkohet nga ofertuesit potencialë, ose përfundimisht nga bartësi i prokurimit, për identifikimin e rreziqeve të mundshme në bazë të ofertës së tij dhe njohjes së kontekstit. Pastaj duhet të bëhet monitorimi i rrezikut në fazat kryesore të zbatimit të kontratës.	Të gjitha kontratat

➲ Procedura e kontrollit mbi ekzekutimin e kontratës

Sektori/Seksioni për Prokurime Publike duhet në kohë të duhur dhe rregullisht t'i pranojë të dhëna për rrjedhën e zbatimit të kontratës së lidhur.

Për këtë qëllim, është mirë komuna të ketë miratuar një procedurë interne për mbikëqyrjen mbi shpenzimin buxhetit brenda së cilës do të përfshihet procesi i monitorimit të kontratave. Komuna mund të përgatisë Procedurë për realizimin e shpenzimeve të buxhetit të komunës.

Kjo procedurë do t'i përfshinte të paktën informacionet si vijon:

- numrin rendor të prokurimit publik;
- numrin e kontratës së lidhur;
- zërin buxhetor nga i cili janë siguruar mjete për kontratën;
- datën e lidhjes së kontratës;
- emërtimin e operatorit ekonomik;
- afatin e zbatimit të kontratës (faza individuale, nëse ka);
- evidencën individuale për realizimin sipas sasive, cilësisë dhe vlerave që korrespondojnë plotësisht me atë që është ofertuar në procedurën e prokurimit publik;
- evidencën e livrimit në kohë të duhur të të mirave të porositura;
- evidencën e faturave dhe borxheve të shlyera sipas kontratës dhe konform vlerës së urdhrave të lëshuar të punës/të mirave të porositura.

Me qëllim të monitorimit efektiv mbi realizimin e kontratës, kurse në përputhje me procedurën paraprakisht të miratuar, personi/personat që janë pjesë të procesit janë të detyruar të menaxhojnë dhe mbledhin në mënyrë të duhur dhe kronologjike dokumentacionin për rrjedhën e zbatimit të kontratës dhe të njëjtin t'ia bashkëlidhin raportit për monitorimin e zbatimit të kontratës.

Personi/personat e ngarkuar për monitorimin e zbatimit të kontratës së prokurimit publik ose marrëveshjes kuadër janë të detyruar:

- të komunikojnë me shkrim me bartësin e prokurimit dhe të kujdesen për realizimin e objektit të kontratës në përputhje me kushtet e kontratës dhe kërkesat në specifikimet teknike;
- rregullisht të marrin pjesë në takimet e punës për monitorimin e dinamikës së zbatimit të kontratës; në rastet kur afati i livrimit/sigurimit nuk fillon në ditën e lidhjes së kontratës, atëherë duhet të përgatisin dhe bashkë me bartësin e prokurimit, ta nënshkruajnë procesverbalin në lidhje me fillimin e zbatimit të kontratës;

- ta bëjnë pranimin kuantitativ dhe kualitativ të mallrave, shërbimeve ose punëve, ndërkaq për të njëjtën hartohet:
  - procesverbal për pranimin kuantitativ të mallrave ose shërbimeve, me të cilin konfirmohet pranimi i sasisë së caktuar dhe llojit të kërkuar të mallrave ose shërbimeve, si dhe pranimi i dokumentacionit të nevojshëm (fleta e ngarkesës, fatura hyrëse, dhe ngjashëm); dhe
  - evidenca e pranimit kualitativ të mallrave ose shërbimeve, me të cilat konfirmohet se mallrat ose shërbimet e livruara plotësisht korrespondojnë me atë që është kontraktuar;
- ta monitorojnë dinamikën e shpenzimit të mjeteve financiare të kontratës me shumën e fondeve/mjeteve në dispozicion të buxhetit/planit financiar, kështu që duhet të bashkëpunojnë me Sektorin/Seksionin e Financave;
- ta mbledhin të gjithë dokumentacionin relevant për livrimin/sigurimin e mallrave/shërbimeve (procesverbale, aktvendime, certifikata, specifikime, udhëzime, dhe ngjashëm);
- ta monitorojnë afatin e garancisë bankare për zbatimin në kohë të duhur dhe në mënyrë cilësore të kontratës, të paraqesin kërkesë për realizimin e saj, ose të paraqesin kërkesë për vazhdimin e afatit të garancisë, nëse është e nevojshme;
- ta firmosin çdo faturë të lëshuar në përputhje me kontratën dhe me çdo faturë të paraqesin raport për shkallën e zbatimit të kontratës në Sektorin/Seksionin për Prokurime Publike;
- ta njoftojnë me shkrim Sektorin/Seksionin për Prokurime Publike dhe personin përgjegjës të autoritetit kontraktor për probleme të mundshme që do të pengonin zbatimin e kontratës;
- të përpilojnë raporte të jashtëzakonshme ose justifikime për ndryshimet e domosdoshme në kontratë, të cilat janë të detyruar t 'i paraqesin në kohën e duhur në Sektorin/Seksionin për Prokurime Publike, me qëllim të ndryshimit të kontratës, nëse ka bazë ligjore; dhe
- pas zbatimit të kontratës, ta dorëzojnë të gjithë dokumentacionin pranë Seksionit për Prokurime Publike, bashkë me listën e dokumentacionit për të cilat dorëzohet vërtetim për pranim.

Nëse Sektori/Seksioni për Prokurime Publike merr informacione nga personi/personat përgjegjës për monitorimin e realizimit të kontratës në mënyrë jo të plotë, jo cilësore dhe jo në kohë të duhur, atëherë Sektori/Seksioni për

Prokurime Publike do t'i ndërmerr të gjitha aktivitetet për ta paralajmëruar ofertuesin e përzgjedhur se e ka për detyrë t'i respektojë detyrimet kontraktore. Nëse aktivitete e ndërmarra nga Sektori/Seksioni për Prokurime Publike nuk mundësojnë vazhdimin e realizimit të kontratës konform detyrimeve të ndërmarra kontraktore, atëherë Sektori/Seksioni për Prokurime Publike do të ndërmerr aktivitete për të sanksionuar një sjellje të tillë të ofertuesit të përzgjedhur. Këto aktivitete janë:

- arkëtimi i dënimit kontraktor;
- realizimi i mjeteve të fituara financiare për sigurimin e detyrimeve kontraktore;
- prishja e kontratës (si mjet i fundit) etj.

Nëse kontrata është realizuar sipas kushteve dhe kërkesave në DT dhe ofertës, përpilohet procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumentacionit me një listë të bashkëngjitjeve/bashkëlidhjeve që dorëzohen në formularin organizativ për prokurime publike. Procesverbali i pranim-dorëzimit i përmban të dhënat si vijon:

- numrin e kontratës të cilës i referohet;
- llojin e prokurimit publik;
- palët kontraktore;
- vlerën e kontraktuar për ekzekutimin e kontratës;
- vlerën e realizuar në total të kontratës;
- listën, numeracionin dhe emërtimin e dokumenteve të veçanta; dhe
- llojin e mjeteve të sigurisë për evitimin e mangësive në periudhën e garancisë, datën e fillimit dhe datën e skadimit të periudhës së garancisë.

Gabimet më të shpeshta që bëhen gjatë ekzekutimit të kontratës

- Ndryshimi i çmimit të kontraktuar, edhe pse në dokumentacionin e tenderit nuk është parashikuar një bazë për të njëjtin.
- Ndryshimi i çmimit të kontraktuar në pjesën për të cilën nuk zbatohen dispozitat për variabilitetin e çmimeve të parashikuara në DT,, për shembull, siç është rasti kur, për shkak të ndryshimeve të çmimit të karburantit, rritet çmimi i transportit, por organi kontraktor lejon jo vetëm ndryshimin e çmimit në raport me shpenzimet e transportit, si një element në strukturën e çmimit për shkak të të cilit lejohen ndryshimet e çmimit, madje edhe ndryshimi i marzhës së ofertuesit të përllogaritur si përqindje e çmimit të karburantit.
- Ndryshimi i kushteve dhe mënyrave të pagesës,, kështu që për shembull, është realizuar një pagesë e tërësishme ose e pjesshme me avans të çmimit të kontraktuar, edhe pse kontrata e prokurimit publik parashikon që pagesa të bëhet vetëm pas përfundimit të plotë të punimeve, respektivisht pasi të jenë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktore nga ana e ofertuesit.
- Ndryshimi i afatit kontrakual, në mënyrë që autoriteti kontraktor ta lejojë ofertuesin e përzgjedhur ta livrojë mallin, ta realizojë shërbimin ose ta kryejë punën më gjatë se afati i ofruar apo do t'i lejojë që të vonohet me përmbushjen e detyrimeve kontraktore.
- Ndryshimi i objektit të prokurimit, në mënyrë që autoriteti kontraktor ta lejojë ofertuesin të livrojë diçka që është me cilësi më të dobët dhe karakteristika më të dobëta teknike në krahasim me ofertën (e njëjta gjë vlen edhe për ofrimin e shërbimeve ose kryerjen e punëve).
- Ndryshimi i objektit të prokurimit, në mënyrë që autoriteti kontraktor ta lejojë ofertuesin të livrojë diçka që nuk është parashikuar as në kontratën për furnizimin publik.
- Ndryshimi i sasisë së kontraktuar të mallrave që duhet të livrohen, respektivisht ndryshim i vëllimit të kontraktuar të punëve ose shërbimeve, në mënyrë që organi kontraktues të kërkojë ose të lejojë realizimin e një sasie më të madhe se ajo që është specifikuar në kontratë.
- Ndryshime nga ana e ofertuesit të përzgjedhur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të lejojë në vend të ofertuesit që i ka përmbushur kushtet për kualifikim në procedurën e prokurimit publik kurse oferta e tij në atë procedurë është përzgjedhur si më e volitshmja në bazë të kriterit paraprakisht të paracaktuar, prokurimin ta realizojë ndonjë subjekt tjetër që nuk është specifikuar në ofertën e përzgjedhur.

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA për monitorimin e ekzekutimit të kontratave

- Krijimi i evidencës së vetme në lidhje me kontratat e lidhura/RS , objektet e prokurimit, afatet, detyrimet e bartësve të prokurimit, sasinë dhe realizimin financiar, etj.
- Përcaktimi i indikatorëve për monitorimin e progresit fizik dhe financiar gjatë realizimit të kontratës në një periudhë të caktuar kohore dhe monitorimi i vazhdueshëm i tyre.
- Krijimi i dokumentacionit kronologjik për të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë realizimit të kontratës.
- Rregullimi i pranimit me komision të mallrave dhe shërbimeve me akt intern.

Indikatori i menaxhimit të kontratave në praktikë

Me qëllim të përmirësimit të praktikave në bazë të përllogaritjeve të bëra dhe informacioneve kthyese nga palët e interesuara, rekomandohet që komuna të instalojë një indikator për menaxhimin e kontratave në praktikë.

Ky indikator vlerëson deri në cilën shkallë mallrat, shërbimet dhe punët e prokurimit janë livruar në përputhje me dispozitat e kontratës për sa i përket afateve kohore, cilësisë, shpenzimeve dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratë, të cilat mbështesin realizimin efikas dhe efektiv të shërbimeve publike.

KRITERET E VLERËSIMIT:

1. **Kontratat zbatohen në kohën e duhur**.
2. Është bërë **verifikimi, kontrolli i cilësisë, mbikëqyrja e punëve dhe përfundimisht pranimi i produkteve nga ana e komunës.**
3. **Faturat janë kontrolluar, ndërsa pagesa është bërë në përputhje me kontratën.**
4. **Ndryshimet/anekset e kontratave janë kontrolluar, procesuar dhe publikuar në kohë të duhur.**
5. **Statistikat e prokurimit janë të aksesshme ndërkaq ekziston një sistem për matjen dhe përmirësimin e praktikave të prokurimit.**
6. Të dhënat janë të plota dhe të sakta dhe lehtësisht të aksesshme në një skedar.

INDIKATORËT E REKOMANDUAR KUANTITATIV që duhet ta mbështesin vlerësimin e këtij indikatori në raport me kriteret e lartpërmendura të vlerësimit:

1/1: Tejkalimi i afateve kohore (në %; vonesa mesatare në ditë)

2/1: Masat e kontrollit të cilësisë dhe përfundimisht pranimi i produkteve u zbatua në përputhje me dispozitat e kontratës (në %)

3/1: Vonohen pagesat e faturave (në %; dhe vonesa mesatare në ditë)

4/1: Ndryshimet/anekset e kontratave (në % nga numri i përgjithshëm i kontratave; rritja mesatare e vlerës së kontratave në %)

Burimi i të dhënave: Dosja e objektit të prokurimit.

Me këtë indikator mund të konstatohet nëse ka tejkalime të shpenzimeve dhe kohës, duke i përfshirë edhe pagesat që duhet t'u bëhen bartësve të prokurimeve.

➲ **Shtojca: Aneksi nr. 3 Shtojca e monitorimit të ekzekutimit të kontratës**

HAPI 3.

NDRYSHIMI I KONTRATËS GJATË VLEFSHMËRISË SË SAJ

Nëse planifikimi është bërë në mënyrë cilësore, nëse specifikimet teknike janë gjithëpërfshirëse dhe nëse kontrata është hartuar me kujdes, atëherë nevoja për ndryshimin e kontratës ose dakordësimi për livrime shtesë të mallrave, shërbimeve ose punëve gjatë zbatimit të kontratës është në minimum.

Ndryshimet e kontratës gjatë vlefshmërisë së saj janë parashikuar në LPP, megjithatë në praktikë komunat vështirë mund të prononcohen nëse dhe kur mund t'i aplikojnë këto dispozita për ta ndryshuar kontratën.

Në të vërtetë, ndryshimi i kontratës së lidhur paraqet shkelje të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë, kështu që me LPP ndalohet sjellja e këtillë, e cila mund të ndikojë në çrregullimin e tregut. Megjithatë, në praktikë, mund të shfaqet nevoja për ndryshime të kufizuara në kontratën ekzistuese të prokurimit publik pa pasur nevojë për zbatimin e një procedure të re të prokurimit publik, në rastet e përshkruara më poshtë.

Ndryshime të cilat janë parashikuar në mënyrë të qartë në dokumentacionin e tenderit

"Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të ndryshohen pa procedurë të re të prokurimit publik...

(1) nëse ndryshimet, pavarësisht nga vlera e tyre monetare, parashikohen në dokumentacionin e tenderit për prokurimin me dispozita të qarta, të sakta dhe pa ekuivoke për ndryshimin, të cilat mund të përfshijnë dispozita ose opsione për ndryshimin e çmimit. Këto dispozita përcaktojnë shtrirjen dhe natyrën e ndryshimeve ose opsioneve të mundshme, si dhe kushtet në të cilat ato mund të përdoren. Ato nuk parashikojnë ndryshime ose opsione që do të ndryshonin natyrën e përgjithshme të kontratës ose marrëveshjes kuadër."

Dispozitat për ndryshimin e kontratës, të parashikuara në DT, mund të sigurojnë një shkallë të caktuar fleksibiliteti në kushtet e kontratës. Por duhet pasur kujdes që këto dispozita të mos formulohen në mënyrë të përgjithshme dhe të mbulojnë të gjitha ndryshimet e mundshme, pasi kjo do të cenonte parimin e transparencës dhe do të sillte rrezikun e trajtimit të pabarabartë.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË KEQE

DT zakonisht e parashikon kushtin si vijon: "Gjatë zbatimit të kontratës, ajo mund të ndryshohet në përputhje me nenin 119 të Ligjit për Prokurime Publike", pa pasur dispozita të qarta, të sakta dhe pa ekuivoke për ndryshimin e kontratës.

Në dispozitat që ndryshojnë kontratën doemos duhet të specifikohet vëllimi dhe natyra e ndryshimeve ose opsioneve të mundshme, si dhe kushtet në të cilat ato mund të përdoren, me ç'rast zvogëlohet hapësira për keqpërdorim.

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

Nëse parashikohet një opsion për 10 tableta shtesë në DT dhe në Kontratën Model për prokurimin e 30 tabletave, livrimi i këtij opsioni do të konsiderohet si ndryshim në përputhje me kushtet e kontratës, dhe jo si një kontratë e re. Kjo mundësi duhet të specifikohet në mënyrë eksplicite në DT ndërsa vlera e saj duhet të përfshihet në përllogaritjen e vlerës së vlerësuar të prokurimit, madje edhe nëse kjo mundësi nuk përdoret.

➲ Punë, shërbime ose mallra shtesë

"Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të ndryshohen pa procedurë të re të prokurimit publik...

(2) për punë, shërbime ose mallra shtesë të cilat i livron bartësi fillestar i prokurimit që janë bërë të domosdoshme, ndërkaq nuk janë përfshirë në kontratën themelore, nëse ndryshimi i bartësit të prokurimit:

- **nuk mund të kryhet për arsye ekonomike ose teknike, të tilla si kërkesat për shkëmbim ose interoperabilitet me pajisjen, shërbimet ose instalacionet ekzistuese të siguruara në kuadër të procedurës fillestare, dhe**
- **do të shkaktonte vështirësi të konsiderueshme ose do t'i rriste në nivel të konsiderueshëm shpenzimet e autoritetit kontraktor.**

... Megjithatë, çdo rritje e çmimit nuk guxon të kalojë 20% të vlerës së kontratës bazë. Kur bëhen disa ndryshime të njëpasnjëshme, ky kufizim aplikohet mbi vlerën e të gjitha ndryshimeve së bashku."

Dispozita e mësipërme do të aplikohet kur rrethanat që kërkojnë ndryshimin ishin të parashikueshme, por komuna nuk i ka identifikuar ato ose nuk i ka parashikuar për arsye të tjera.

Këto baza për ndryshime mund të përdoren vetëm kur dy kushtet e mësipërme plotësohen **në mënyrë kumulative**, me ç'rast shprehjet "vështirësi të konsiderueshme" dhe "rritje të konsiderueshme të shpenzimeve" duhet të interpretohen në mënyrë strikte.

SHEMBULL

Në rast se nevojiten punë shtesë në një objekt të papërfunduar, ku akoma është prezent bartësi fillestar i prokurimit , atëherë me sa duket do të paraqiten probleme me interoperabilitetin ekonomik ose teknik, për shembull, me sigurimin dhe menaxhimin e rrezikut, nëse kantieri i kalon një kontraktori tjetër. Angazhimi i një kontraktori të ri në këto rrethana ka të ngjarë të rezultojë edhe deri në dyfishimin e shpenzimeve.

Sa i përket mënyrës së përcaktimit të çmimeve të paparashikuara dhe/ose pozicioneve shtesë, duhet të zbatohet praktika e mirë afariste që ekziston në fushën e ndërtimit, kështu që para se të kërkohet çmimi për pozicionet që duhet të realizohen në mënyrë plotësuese nga bartësi i prokurimit, mund të bëhet hulumtimi i tregut në mënyrë që të përcaktohen çmimet e tregut. Gjatë hulumtimit të tregut, komuna mund ta përfshijë mbikëqyrjen profesionale ose projektuesin.

Në këtë lloj ndryshimi vlen kushti i transparencës, që do të thotë se në rast se komuna e ka shfrytëzuar këtë mundësi dhe ka bërë një ndryshim në kontratë ose marrëveshje, brenda (dhjetë) ditëve nga data e ndryshimit të kontratës së prokurimit publik ose marrëveshjes kuadër, ajo duhet ta publikojë njoftimin për ndryshimin e kontratës gjatë vlefshmërisë së saj, me një kopje të ndryshimit të kontratës.

➲ Ndryshime për shkak të rrethanave të paparashikuara

"Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të ndryshohen pa procedurë të re të prokurimit publik nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- **nevoja për ndryshim është shfaqur për shkak të rrethanave të cilat autoriteti kontraktor nuk mund t'i parashikonte;**
- **me ndryshimin në mënyrë thelbësore nuk ndryshohet natyra e kontratës;**
- **ndryshimet e kontratës ose marrëveshjes nuk guxon të tejkalojnë 20% të vlerës së kontratës ose marrëveshjes kuadër fillestare. Kur bëhen disa ndryshime të njëpasnjëshme, ky kufizim aplikohet mbi të gjitha ndryshimet së bashku."**

Shfrytëzimi i mundësisë për ndryshimin e kontratës mbi këtë bazë duhet të justifikohet me faktin se nevoja për ndryshime është shfaqur si pasojë e rrethanave të cilat komuna që punon me ndërgjegje nuk ka mundur t'i parashikojë, pavarësisht përgatitjes së kujdesshme të dokumentacionit të tenderit përmes të cilit ishte akorduar kontrata fillestare. Së këtejmi, termi "komuna që punon me ndërgjegje nuk ka mundur t'i parashikojë" duhet të interpretohet në mënyrë strikte.

Në këtë lloj ndryshimi vlen kushti i transparencës, që do të thotë se në rast se komuna e ka shfrytëzuar këtë mundësi dhe ka bërë një ndryshim në kontratë ose marrëveshje, brenda (dhjetë) ditëve nga data e ndryshimit të kontratës së prokurimit publik ose marrëveshjes kuadër, doemos duhet ta publikojë njoftimin për ndryshimin e kontratës gjatë vlefshmërisë së saj, me një kopje të ndryshimit të kontratës.

SHEMBULL

Shembulli i këtillë është kur janë shfaqur punë të paparashikuara për shkak të ekzistimit të zbulimeve nëntokësore ose instalacioneve nëntokësore gjatë realizimit të punëve ndërtimore.

➲ Zëvendësimi i partnerit kontraktor

Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të ndryshohen pa procedurë të re të prokurimit publik...

- **nëse bartësin fillestar të prokurimit e zëvendëson një operator tjetër ekonomik, që i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara, fillimisht në dokumentacionin e tenderit nga procedura e zbatuar dhe që është pasardhësi ligjor i bartësit fillestar të prokurimit pas ristrukturimit të ndërmarrjes, përfshirë këtu transferimin, bashkimin, bashkëngjitjen ose falimentimin, nëse kjo nuk përfshin ndryshime të tjera të konsiderueshme të kontratës dhe me këtë nuk shmanget zbatimi i këtij ligji."**

Lidhur me bazën e mësipërme, identiteti ligjor i bartësit të prokurimit nuk ndryshon dhe në të vërtetë bartësi i prokurimit mbetet i njëjtë, meqë këto ndryshime më së shpeshti janë rezultat i riorganizimit të brendshëm, transferimeve, bashkëngjitjeve, etj.

➲ Ndryshimi nuk është esencial

"Kontratat dhe marrëveshjet kuadër mund të ndryshohen pa procedurë të re të prokurimit publik...

- **nëse ndryshimi, pavarësisht vlerës së tij, nuk është esencial."**

Ndryshimi i kontratës konsiderohet se nuk është esencial nëse nuk e ndryshon natyrën e saj. Sa më të konsiderueshme të jenë ndryshimet në lidhje me kontratën themelore, aq më shumë ka të ngjarë se do të duhet të zbatohet një procedurë e re e prokurimit publik.

SHEMBULL

Kur autoriteti kontraktor duhet ta shtyjë kohëzgjatjen e kontratës, meqë procedura e re vonohet për shkak të ankese, përkatësisht kur bëhet fjalë për një zgjatje të papërfillshme të kohëzgjatjes së kontratës, atëherë është më mirë të zgjatet kontrata sesa AK të mbetet pa prokurimet e nevojshme apo të shkojë me një procedurë të negociuar në bazë të urgjencës. Megjithatë, në mënyrë adekuate duhet të justifikohen arsyet që çuan në nevojën e këtillë dhe justifikimin pse ndryshimet nuk janë thelbësore.

HAPI 4.

PËRFUNDIMI I KONTRATËS

Pasi autoriteti kontraktor zyrtarisht ta pranojë livrimin e fundit të objektit të kontratës dhe t'i paguajë faturat, kontrata e prokurimit publik përfundon.

Në raste të caktuara, përfundimi i mirëfilltë i kontratës konsiston me përfundimin e garancisë, ose me periudhën e përgjegjësisë për defektet, apo me periudhën e mbajtjes (pagesës së këstit të fundit).

Kthimi i garancisë bankare për ekzekutimin e kontratës në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore

Nëse kërkohet garanci për ekzekutimin e kontratës në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore, ajo kthehet nga Sektori/Seksioni për Prokurime Publike brenda 14 ditëve nga dita e realizimit të plotë të kontratës. Për kthimin e garancisë bankare duhet të sigurohet prova: data, emri dhe mbiemri dhe nënshkrimi i personit i cili në emër të bartësit të prokurimit e ka ngritur garancinë.

Lëshimi i vërtetimit për ekzekutimin e kontratës në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore

Në përfundim të kontratës, disa bartës të prokurimit mund t'i kërkojnë autoritetit kontraktor t'u lëshojë atyre një vërtetim për ekzekutimin/zbatimin e kënaqshëm të kontratës. Komuna është e detyruar të lëshojë një vërtetim nëse kontrata është realizuar plotësisht sipas kushteve kontraktuese.

VINI RE! Moslëshimi i vërtetimit për realizimin e kontratës në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore nga komuna, vë në dukje mosrespektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe parimit të sigurimit të konkurrencës midis operatorëve ekonomikë.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që autoriteti kontraktor të miratojë konkluzione dhe të nxjerrë mësime kryesore nga kontrata e ekzekutuar. Për shembull, personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës mund t'u përgjigjet disa prej pyetjeve të mëposhtme:

- A e morëm atë që e kërkonim?
- A morëm atë që në të vërtetë na duhej?
- A shohim ndonjë diferencë? Nëse e shikojmë, a mund ta shpjegojmë këtë diferencë?
- A kemi mësuar ndonjë gjë (pozitive ose negative) në lidhje me kontratat/projektet e ardhshme?
- Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

Në kontratat më komplekse (p.sh. kontratat për kryerjen e punëve ndërtimore), personi i ngarkuar për monitorimin e zbatimit të kontratës mund të caktojë **një takim përfundimtar** me palët kryesore të përfshira, në të cilin do të bëhet vlerësimi se sa e suksesshme është kontrata në krahasim me pritshmëritë fillestare.

Ky takim duhet të mundësojë:

- të informohen të gjitha palët e interesuara të përfshira lidhur me rezultatet e zbatimit të kontratës;
- t'ju shprehet një mirënjohje atyre që kontribuan në suksesin e projektit. Shprehja e mirënjohjes dhe falënderimit për ata që kanë kontribuar në projekt do të rrisë gjasat e angazhimit të tyre në të ardhmen;
- të mësojnë nga gabimet e bëra, problemet ose rreziqet e jashtme dhe analiza e mënyrës me të cilën problemet mund të zgjidhen ose minimizohen; dhe
- të përpilohen mesazhe dhe rekomandime kryesore për kontratat e ardhshme.

Respektimi i parimit të transparencës gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave

Komuna përmes Sektorit/Seksionit për Prokurime Publike ka detyrim ligjor që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e zbatimit të plotë të kontratës në SEPP ta publikojë njoftimin për realizimin e kontratës (https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx #/realised-contract).

Në rastin e marrëveshjes kuadër, njoftimi për të gjitha kontratat individuale që janë zbatuar në tre muajt e fundit në bazë të marrëveshjes kuadër, do të publi-

kohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas skadimit të çdo tremujori (https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx#/evidences/3).

SHEMBUJ TË PRAKTIKËS së mirë për transparencë më të madhe

- Për të siguruar transparencë më të madhe, komuna, këto njoftime për realizimin e kontratave/marrëveshjeve, mund t'i publikojë edhe në faqen e saj të internetit, në seksionin e parashikuar për informacione në lidhje me prokurimet publike.
- Komuna, mund të hartojë dhe ta publikojë në faqen e saj të internetit një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha kontratave të realizuara në vitin aktual me të dhëna për vlerën e vlerësuar, vlerën e kontratës së lidhur, vlerën e kontratës së realizuar në shumën absolute dhe relative, si dhe një përshkrim të shkurtër nëse kontrata është realizuar me cilësi dhe në kohën e duhur, para ose mbas kohës së parashikuar me afatin, si dhe cilat janë arsyet e vonesave.
- Komuna, mund të krijojë dhe publikojë në faqen e saj të internetit një listë të operatorëve ekonomikë, të cilët kontratat i kanë realizuar para kohe dhe me cilësi dhe një listë të operatorëve ekonomikë të cilët kontratën e kanë realizuar me vonesë ose në mënyrë jocilësore.
- Komuna, mund të zhvillojë indikatorë për prokurime publike që do t'i shpallë publikisht në nivel vjetor (në fillim të vitit për vitin paraprak) me qëllim identifikimin e dobësive në sistemin e prokurimeve publike në nivel të autoritetit kontraktor (komunës).

HAPI 5.

PRISHJA E KONTRATËS

Prishja e kontratës nënkupton ndërprerje të kontratës juridikisht të vlefshme e cila akoma nuk është përmbushur ose është përmbushur vetëm pjesërisht.

Kontrata e prokurimit publik mund të prishet në dy mënyra:

- me ujdi, përkatësisht me pajtimin e ndërsjellë të të dyja palëve kontraktore ose;
- në mënyrë të njëanshme, përkatësisht me kërkesë të njërës prej palëve kontraktore,

Autoriteti kontraktor mund ta prishë kontratën e prokurimit publik ose marrëveshjen kuadër gjatë vlefshmërisë nëse:

a) kontrata është ndryshuar në masë të konsiderueshme, që rezulton në detyrimin për zbatimin e procedurës së re të prokurimit publik;

b) bartësi i prokurimit ka qenë në një nga situatat për shkak të të cilave autoriteti kontraktor është dashur ta përjashtojë atë nga procedura e prokurimit publik, por nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti gjatë procedurës ose;

c) kontrata ose marrëveshja kuadër nuk duhet t'i akordohet bartësit të prokurimit për shkak të shkeljeve serioze të këtij ligji, të cilat përcaktohen me vendim gjyqësor të formës së prerë nga gjykata kompetente.

SHËNIM: Kontrata e prokurimit publik duhet paraprakisht t'i përcaktojë dispozitat e veçanta që e rregullojnë prishjen e kontratës. Për më tepër, është praktikë e mirë që këto dispozita të parashikohen qysh në përgatitjen e Kontratës Model/marrëveshjes që është pjesë e DT.

Si të rritet transparenca dhe llogaridhënia në lidhje me kontratat e prishura të prokurimit publik

SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

Komuna, përmes Sektorit/Seksionit për Prokurime Publike, mund të udhëheqë dhe të publikojë rregullisht në faqen e saj të internetit një "Listë të zezë të operatorëve ekonomikë me të cilët komuna e ka prishur në mënyrë të njëanshme kontratën në periudhën e kaluar", me përmbajtjen e mëposhtme: emërtimi dhe selia e subjektit me të cilin është prishur kontrata, një përshkrim të shkurtër të arsyeve për prishjen e kontratës, a është aktivizuar garancia bankare, a është kërkuar dëmshpërblim ose a janë ndërmarrë sanksione të tjera nga komuna, dhe ngjashëm.

Parakusht për krijimin e kësaj liste është ekzistenca e një evidence të rregullt dhe të dokumentuar në lidhje me rrjedhën kronologjike të aktiviteteve për prishjen e njëanshme të kontratës, të siguruar nga sektori/seksioni që është kërkuesi dhe monitoron zbatimin e kontratës dhe më pas ia dorëzon atë Sektorit/Seksionit për Prokurime Publike.

Kjo listë është mjaft e dobishme edhe për procedurat e ardhshme të prokurimit publik, sepse i jep komunës të drejtën ligjore për të përjashtuar nga procedurat e ardhshme të prokurimit publik operatorin ekonomik që ka treguar mangësi të konsiderueshme ose të vazhdueshme në përmbushjen e detyrimeve kryesore të kontratave të mëparshme të prokurimit publik të kontraktuara me komunën, duke rezultuar në prishjen e njëanshëm të kontratës, duke kërkuar dëmshpërblim ose duke ndërmarrë sanksione të tjera të ngjashme nga ana e komunës. Duke vepruar kështu, komuna këtë të drejtë mund ta përdorë vetëm në rast se DT e ka parashikuar këtë kusht opsional për përjashtimin e OE nga procedura e prokurimit publik.

2.5. Garancitë si mekanizëm për mbrojtjen e komunave gjatë realizimit të kontratave të prokurimit publik.

Ekzistojnë dy lloje garancish që komunat, si autoritete kontraktore, mund t'i kërkojnë nga ofertuesi në kuadër të procedurës së prokurimit publik. Ato janë:

- Garancia e ofertës në formën e një garancie bankare ose një deklarate për seriozitetin e ofertës, nëse ofertuesi e revokon ofertën e tij para skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj;
- Garancia e ekzekutimit cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës në formën e garancisë bankare, e cila është e vlefshme si garanci nëse ofertuesi/kontraktori, të cilit i është akorduar kontrata, nuk i kryen detyrimet e tij sipas kontratës ose i kryen ato në mënyrë jo të drejtë.

Duke e përjashtuar paragrafin paraprak, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë garanci për ofertën në formën e garancisë bankare sa i përket prokurimit me vlerë të vogël dhe procedurës së thjeshtuar të hapur.

Autoriteti kontraktor e arkëton garancinë bankare të ofertës nëse ofertuesi:

- e revokon ofertën e tij para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së saj;
- nuk e pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike nga ana e komisionit;
- nuk e nënshkruan kontratën e prokurimit publik në përputhje me kushtet e dokumentacionit të tenderit dhe ofertës së paraqitur ose;
- nuk e siguron garancinë për ekzekutimin cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës, nëse autoriteti kontraktor e ka parashikuar në dokumentacionin e tenderit.

Garancia bankare e ofertës nuk guxon të jetë më e madhe se 3% nga vlera e ofertës pa TVSH.

Lartësia e garancisë për ekzekutimin cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës mund të jetë nga 5% deri në 15% të vlerës së kontratës së prokurimit publik.

Garancia për ekzekutimin cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës nuk kërkohet në konkursin për zgjedhjen e zgjidhjes ideore, tek kontratat e prokurimit publik të shërbimeve konsulente dhe gjatë akordimit të marrëveshjes kuadër. Garanci për ekzekutimin cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës mund të kërkohet vetëm për kontratat individuale, të cilat akordohen në bazë të marrëveshjes kuadër.

REKOMANDIMI PËR PRAKTIKË TË MIRË

Komuna, në kushtet e tenderit, duhet të parashikojë deponimin garancisë bankare për ekzekutimin cilësor dhe në kohën e duhur të kontratës nga ofertuesi më i favorshëm i përzgjedhur njëkohësisht me kopjet e nënshkruara të kontratës, me ç'rast kontrata duhet paraprakisht të nënshkruhet nga personi përgjegjës i komunës.

3

INDIKATORI I RREZIKUT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Për të identifikuar dobësitë në sistemin e prokurimeve publike në nivel të autoritetit kontraktor (komunës) dhe për të punuar në përmirësimin e tyre, rekomandohet që komuna të zhvillojë indikatorë të prokurimeve publike të cilat do t'i përllogarisë një herë në vit për vitin paraprak dhe do t' i shpallë publikisht.

Indikatorët janë të dedikuar për vetëvlerësimin, rangimin/listimin dhe krahasimin e komunës me autoritetet e ngjashme kontraktore (komunat) ose me vlerën mesatare të të gjitha komunave për të arritur një qëllim të caktuar – avancimin e sistemit të prokurimit publik në nivel të komunës.

Indikatorët nuk janë të dedikuar për të "akuzuar" komunën dhe madje nuk janë as provë për "punë të parregullt".

Ato janë udhëzues, frymëzim për avancimin e rezultateve personale.

Me publikimin e indikatorëve të rrezikut të prokurimeve publike në faqen e internetit të komunës arrihet transparencë e plotë në punën e prokurimeve publike dhe fuqizohet besimi tek komuniteti afarist dhe qytetarët.

3.1. Propozim lista e indikatorëve të rrezikut të prokurimeve publike:

1) **Ndryshime të planit vjetor të prokurimeve publike**
2) **Ndryshime të vlerës së vlerësuar të prokurimit**
3) **Respektimi i afatit për vendim-marrje sa i përket zgjedhjes/anulimit**
4) **Numri mesatar i ofertave, pjesëmarrja në procedura konkurruese, përfaqësimi i kontratave me një ofertë**
5) **Shpërndarja e prokurimeve publike komunale për operatorët ekonomikë**
6) **Integrimi gjinor në kontratat e lidhura të prokurimeve publike**
7) **Procedurat e anuluara të prokurimeve publike**
8) **Procedurat e ankimuara të prokurimeve publike**
9) **Mospërputhja midis kontratave të planifikuara, të lidhura dhe të realizuara të prokurimeve publike**

➲ **Shtojca:**

Aneksi nr.1 (Excel doc) – përmban tabelë për secilin indikator veçmas me formula të integruara për llogaritjen e indikatorit.

Aneksi nr.2 (Word doc) – përmban justifikim për rëndësinë e secilit prej treguesve të mësipërm veç e veç, ndërkaq janë prezantuar elementet e nevojshëm hyrëse dhe mënyrën me të cilën është arritur rezultati për secilin indikator të propozuar.

4


MENAXHIMI ME PROJEKTE TË MËDHA INFRASTRUKTURORE

4.1. Fillimi i realizimit të projektit dhe zbatimi i procedurës së akordimit të kontratës

Pas përpilimit të dokumentacionit të projektit, zgjidhjes së marrëdhënieve pronësore juridike, marrjes së lejeve dhe pëlqimeve të nevojshme, si dhe sigurimit të burimeve të nevojshme të financimit, projekti infrastrukturor është gati për të filluar me zbatimin. Roli i përfaqësuesve të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe i ndërmarrjeve komunale është i rëndësishëm në secilën nga fazat e mësipërme, që nga programimi dhe identifikimi i projektit, deri në zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike, përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe sigurimin e burimeve financiare.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e projekteve të mëdha infrastrukturore, veçanërisht ato të financuara pjesërisht me burime ndërkombëtare, përfaqësuesit e Vetëqeverisjes Lokale dhe ndërmarrjet komunale janë drejtpërdrejt të përfshirë në lloje të ndryshme të aktiviteteve, sepse pritet të sigurojnë logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore për zbatimin e projektit (koordinimi, çështjet teknike, çështjet organizative, çështjet financiare, çështjet ligjore, çështjet e procedurave ndërkombëtare dhe lidhjes së kontratave, prokurimet publike, dhe ngjashëm). Veç tjerash, në këtë fazë përcaktohen marrëdhëniet kontraktuale me kontraktorët, si dhe me përfaqësuesit e mbikëqyrjes profesionale mbi projektin që implementohet. Këtu përfshihen edhe aktivitetet e zbatimit të të gjitha procedurave administrative dhe teknike për realizimin e projektit, si dhe monitorimi mbi realizimin e projektit (teknik, financiar, kohor). Njëherësh zbatohen aktivitete për adresimin e të dhënave të nevojshme dhe shkëmbimin e informacioneve me autoritetet kompetente në të gjitha nivelet, publikun, financuesit, përdoruesit, si dhe për vënien në funksion të objekteve të ndërtuara infrastrukture, menjëherë pas ndërtimit dhe pranimit teknik të tyre.

Siç mund të shihet në ilustrimin, kemi të bëjmë me një gamë të gjerë aktivitetesh dhe detyrash, në mënyrë që të menaxhohet më mirë me projektin infrastrukturor, **është praktikë e mirë të formohet që në fillim një ekip i projektit ose njësi e menaxhimit me projekte** si një grup pune multidisiplinar i përbërë nga punonjës në shërbimet kompetente të Vetëqeverisjes Lokale, përfaqësues nga ndërmarrjet komunale dhe ekspertë të jashtëm (nëse nevojitet ekspertiza e tyre specifike në faza të caktuara të menaxhimit me projektin infrastrukturor). **Menaxhimi i projekteve të mëdha infrastrukturor e imponon nevojën për komunikim të rregullt dhe koordinim në kohë të aktiviteteve midis të gjithë anëtarëve të ekipit të projektit gjatë të gjitha fazave.**



Duke pasur parasysh se fillimi i zbatimit të projektit lidhet më së shpeshti me aktivitetet për organizimin e procedurës së prokurimit publik, në vijim shpjegohet në detaje procedura e lidhjes së kontratave dhe përcaktimit të marrëdhënieve me kontraktorët, përkatësisht me autoritetet mbikëqyrëse në përputhje me LPP, kushtet e FIDIC për kontraktimin dhe udhëzuesin praktik përmes procedurave kontraktuese të asistuara nga BE me vende të treta PRAG.

4.2. Procedura e akordimit të kontratës për projektin infrastrukturor konform LPP

Procedura e akordimit të kontratës zakonisht ndahet në tri faza kryesore: faza përgatitore, faza e tenderit dhe faza pas tenderit.

Në fazën e parë, përfaqësuesit e komunave duhet të vlerësojnë se cilat mallra, shërbime dhe punë do t'u nevojiten në një periudhë të caktuar dhe për cilin projekt, pas së cilës vlerësohet vlera e nevojave dhe në pajtim me ekipin, sigurohet buxheti adekuat për këto prokurime. Pastaj nevojat përcaktohen më saktë, përkatësisht bëhet specifikim i saktë i objektit të prokurimit dhe

përcaktohet procedura më e mirë e prokurimit. Këtu është e nevojshme të përmendet edhe një herë rëndësia e analizës tekniko-teknologjike në fazën e identifikimit të një projekti për përpilimin e mëvonshëm të dokumentacionit të tenderit dhe specifikimin e qartë të pajisjeve të nevojshme.

Në fazën e dytë, konform planit të prokurimit publik, autoriteti kontraktor publikon një shpallje, bën vlerësimin e ofertave në bazë të kritereve të publikuara dhe ua akordon kontratën e prokurimit publik një ose më shumë ofertuesve, varësisht procedurës.

Faza e fundit i referohet monitorimit të zbatimit të kontratës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga kontrata e nënshkruar.

Lidhja e kontratës, përcaktimi i marrëdhënies me kontraktorin dhe organizimi i procedurës së mbikëqyrjes

Varësisht procedurës së përzgjedhur të prokurimit publik, përfaqësuesit e Vetëqeverisjes Lokale, si autoritet kontraktor, kanë për detyrë ta organizojnë procedurën e tenderit me qëllim përzgjedhjen e një kontraktori cilësor dhe të përshtatshëm (ose më shumë kontraktorë) dhe përcaktimin e marrëdhënies kontraktuale që duhet të sigurojë zbatimin e projektit infrastrukturor sipas dinamikës së parashikuar. Supozimi kryesor për këto aktivitete është përcaktimi i kujdesshëm i detyrës së projektit dhe përgatitja cilësore e dokumentacionit të tenderit, ku dokumentacioni teknik i përgatitur paraprakisht shërben si bazë, duke e përfshirë projektin ideor dhe bazë.

Prandaj, në interes të bartësit të projektit të dokumentacioni teknik, si në aspektin formal ashtu edhe në atë kualitativ, është t'i plotësojë të gjitha kushtet e nevojshme. Njëkohësisht, është e rëndësishme që gjatë procedurës së tenderit, komuna të mundësojë vizitë në lokacionin nga operatorët ekonomikë të interesuar, me qëllim njohjen për së afërmi me terrenin dhe kushtet në të cilat do të realizohet një projekt i caktuar infrastrukturor, me qëllim të përgatitjes së ofertave cilësore dhe realisht të zbatueshme.

Fatkeqësisht, përvojat nga terreni flasin për probleme të shumta kur bëhet fjalë për kryerjen e punëve dhe rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale me kontraktorët. Disa prej tyre janë përshkruar më poshtë.

- Kontraktorët e përzgjedhur në bazë të ofertave të ulëta joreale dhe rekomandimeve "fiktive" kanë qasje të papërgjegjshme ndaj punëve, gjë që shkakton probleme të shumta gjatë kryerjes së punëve (shkelja e afateve, mosrespektimi i procedurave dhe kushteve kontraktore, etj.);

Rekomandim për tejkalimin e kësaj praktikë negative:

Të mos përdoret vetëm kriteri "çmimi më i ulët", por për zgjedhjen e ofertës më të favorshme të përdoret edhe kriteri i proporcionit më të mirë midis çmimit dhe cilësisë apo kriterit dhe shpenzimet e mirëmbajtjes.

Komuna duhet të mbajë llogari për zbatimin konsistent të dispozitave të LPP në lidhje me përdorimin e aftësisë (përvojës) nga një subjekt tjetër, në të vërtetë rregullin se aftësia, përkatësisht përvoja e një subjekti tjetër, mund të përdoret nga OE vetëm nëse subjekti tjetër do t'i kryejë punët ose do të ofrojë shërbimet për të cilat kërkohet një aftësi e tillë.

- Në tenderin paraqiten kontraktorë me rekomandime të mira , por pas marrjes së punës, ata angazhojnë nënkontraktorë dhe punën ua kalojnë nënkontraktorëve me cilësi më të ulët, gjë që përsëri pasqyrohet në shkeljen e afateve dhe mosrespektimin e procedurave dhe kushteve kontraktuale.

Arsyet e praktikës së këtillë negative dhe si ta tejkalojmë atë:

Zbatimi jo përkatës i LPP nga ana e komunës. Nëse OE ka aplikuar me ofertë individuale, gjegjësisht nuk ka paraqitur asnjë nënkontraktor në ofertën e tij, atëherë konform LPP, ai në fazën e realizimit të kontratës mund të inkuadrojë një ose më shumë nënkontraktorë të rinj, me kusht që pjesëmarrja e përgjithshme e këtyre nënkontraktorëve të mos kalojë 30% nga vlera e kontratës së prokurimit publik pa TVSH ndërsa nënkontraktorët e rinj t'i plotësojnë kushtet e aftësisë/ shkathtësisë konform DT. Përveç kësaj, OE e ka detyrimin të sigurojë të dhëna për llojin dhe vëllimin e punëve që planifikon t'ua besojë nënkontraktorëve të rinj.

- Kontraktorët papritur dhe pa paralajmërim futen në probleme financiare dhe e ndërpresin punën (ndodh që disa kontraktorë madje të deklarojnë edhe falimentim gjatë zbatimit të projektit infrastrukturor).
- Kontraktori nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme cilësisë së punëve të kryera ose materialeve të instaluara (nuk përmbushen standardet ose instalohen komponentë me cilësi më të ulët nga cilësia e parashikuar).
- Kontraktori devijon nga projekti bazë dhe me iniciativë personale ndërmerr aktivitete që nuk janë parashikuar në llogaritjen fillestare të punëve.

Arsyet e praktikës së këtillë negative dhe si ta tejkalojmë atë:

Komuna nuk ka angazhuar mbikëqyrje profesionale për të kontrolluar kuantitetin dhe kualitetin e materialeve të instaluara dhe punëve të kryera. Së këtejmi, është

e nevojshme që komuna, paralelisht me procedurën e zgjedhjes së kontraktorit, të zbatojë edhe një procedurë për angazhimin e mbikëqyrjes profesionale që do të ushtrojë kontroll mbi realizimin e punëve.

- Për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe kushteve të tregut që janë shfaqur në ndërkohë (rritja e çmimeve të lëndëve të para, rritja e shpenzimeve të punës, disponueshmëria e kufizuar e pajisjeve), kontraktori nuk është në gjendje ta zbatojë projektin sipas kushteve të kontratës dhe projektit bazë ose kërkon ndryshime të kontratës dhe kompensim të dëmit.
- Kontraktori dhe mbikëqyrja e angazhuar nuk u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme aspekteve kritike të kryerjes së punëve, prandaj paraqitet nevoja për intervenime dhe korrigjime shtesë, gjë që në masë të konsiderueshme e ngarkon projektin dhe zgjat dinamikën e tij kohore.
- Kontraktorët potencialë, si ofertues, e abuzojnë mekanizmin e ankesave dhe ushtrojnë presion ose e kushtëzojnë autoritetin kompetent kontraktor.

Megjithatë, jo çdoherë janë fajtorë vetëm kontraktorët, por një pjesë e madhe e mos përmbushjes së kontratave bëhet edhe me fajin e komunave. Të tilla janë rastet si vijon:

- Dokumentacioni jocilësor teknik. Ndodh që komuna të mos bëjë një detyrë të qartë dhe komplete të projektit, që më vonë do të rezultojë në hartimin jocilësor të dokumentacionit teknik ose projektit bazik, ndërsa projekti i këtillë joadekuat bazik do të shkaktojë një sërë çështje të paparashikuara për shkak të të cilave i njëjti duhet të pësojë ndryshime;
- Nuk janë siguruar të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme të ndërtimit. Komuna ka filluar me realizimin e ndërtimit pa siguruar leje paraprake ndërtimi ose komuna nuk ka parashikuar në kushtet e tenderit se kontraktori duhet të ketë licencë për një kategori ndërtimi që korrespondon me objektin e prokurimit;
- Shpronësimet e pazgjidhura. Komuna nuk i ka zgjidhur shpronësimet para fillimit të punëve ndërtimore, kështu që për ta realizuar më shpejt projektin, ka vendosur t'i zgjidhë të njëjtat gjatë punëve ndërtimore, pa e pasur parasysh faktin se mund të përballet me një shpronësim problematik, që mund të shkaktojë bllokim dhe shkelje të afateve të përcaktuara të realizimit ose në fund të fundit të ballafaqohet me pamundësinë e zbatimit të mëtejshëm të projektit;
- Pagesa në kohë e mjeteve për aktivitetet e realizuara dhe ngjashëm. Bartësi i prokurimit mund të vonohet me realizimin e punimeve ose ta

ndërpresë punën, nëse komuna nuk e shlyen borxhin në kohën e duhur, përkatësisht nëse vonohet me pagesën e disa situatave të përkohshme.

Domethënë , ka shumë probleme dhe sfida me të cilat përballen anëtarët e ekipit të projektit dhe punonjësit në shërbimet e komunës dhe ndërmarrjet komunale në procesin e lidhjes së kontratave dhe gjatë realizimit të punimeve. Megjithatë, meqë ka përvoja të këqija, ka edhe shembuj dhe praktika të mira që dëshmojnë se mund të ndërmerren aktivitete të caktuara për të shmangur situatat e rrezikshme sa i përket kontraktorit. **Një nga rekomandimet në këtë drejtim është përdorimi i mekanizmit garanci për ekzekutimin e kontratës me cilësi dhe në kohën e duhur që është parashikuar në Ligjin për Prokurime Publike.**

Një aspekt tjetër i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së punimeve të realizuara dhe pajisjeve të instaluara është sigurimi i mbikëqyrjes. Duhet të kihet parasysh se në përputhje me legjislacionin në fushën e punimeve ndërtimore (Ligji për Ndërtim), mbikëqyrje mbi ndërtimin në emër të investitorit mund të ushtrojë vetëm personi juridik ose fizik që ka licencë për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi punimet ndërtimore, ndërsa për objektet komplekse për mbikëqyrje mbi punimet e ndërtimit, mund të ushtrojë vetëm personi juridik i cili doemos duhet të ketë një ekip të krijuar për mbikëqyrje. Po ashtu është e rëndësishme që ekipi i projektit ose njësia e menaxhimit të projektit të infrastrukturës t'i parashikojë dhe sigurojë në kohën e duhur mjetet e nevojshme për angazhimin e mbikëqyrjes profesionale. Në praktikë, këto janë kontrata, vlera e të cilave zakonisht lidhet me vlerën e përgjithshme të projektit. Në varësi të specifikave, kompleksitetit dhe vëllimi i madhësisë së vetë projektit, për shërbimin e mbikëqyrjes profesionale nevojitet të ndahen nga 1.5% deri në 3% të vlerës së përgjithshme të projektit infrastrukturor, ndërsa në disa punë specifike ose projekte më komplekse që kanë më shumë faza, këto vlera mund të diversifikohen në mënyrë plotësuese. Gjatë përcaktimit të kushteve të kontratës, duhet të kihet parasysh se autoriteti mbikëqyrës i ka këto detyrime:

- Ta sigurojë realizimin e punimeve në përputhje me lejen e ndërtimit, dokumentacionin teknik dhe dispozitat ligjore dhe nëse kontraktori refuzon të veprojë sipas udhëzimeve të tij dhe vazhdon me ndërtimin e objektit në kundërshtim me lejen e ndërtimit dhe dokumentacionin teknik, e ka për detyrë këtë ta shënojë në regjistrin e ndërtimit dhe pa vonesë ta informojë inspeksionin kompetent të urbanizmit dhe ndërtimit;
- Të përcaktojë se cilësia e punimeve, materialeve të instaluara dhe pajisjes është në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet e përcaktuara me ligjet relevant, aktet normative të miratuara në bazë të këtyre ligjeve, normat dhe standardet teknike, si dhe të marrë pjesë gjatë marrjes së

mostrave për kontroll, përkatësisht mostrat me të cilat dëshmohet cilësia e materialeve të instaluara;

- Ta njoftojë me shkrim inspeksionin kompetent të urbanizmit dhe ndërtimit në rast se rezultatet e analizave të materialeve të instaluara nuk janë në përputhje me aktet normative;
- Ta konfirmojë realizimin e punimeve duke nënshkruar regjistrin e ndërtimit, ta kontrollojë librin e ndërtimit (kur mbahet) dhe t'i kontrollojë të gjitha ndryshimet në dokumentacionin teknik;
- Pa prolongime ta njoftojë institucionin kompetent, kur gjatë realizimit të punimeve has në objekte që kanë karakteristika të trashëgimisë natyrore ose kulturore-historike dhe t'i ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e lokalitetit;
- Ta njoftojë me shkrim investitorin, organin kompetent që ka lëshuar lejen e ndërtimit dhe inspeksionin kompetent për mangësitë në dokumentacionin teknik dhe rrethanat e paparashikuara që janë të rëndësishme për kryerjen e punimeve;
- Të përpilojë një raport për mbikëqyrjen e realizuar pas përfundimit të ndërtimit.

Së këtejmi, mund të konkludohet se legjislacioni në fushën e punimeve të ndërtimit (Ligji për Ndërtim) mundëson përmes angazhimit të mbikëqyrjes profesionale të sigurohet cilësia e punëve të kryera.

Sipas kësaj, **njëra nga mënyrat e sigurimit të cilësisë gjatë zbatimit të projektit të infrastrukturës është zgjedhja e mbikëqyrjes profesionale dhe të ndërgjegjshme që do t'i mbrojë interesat e projektit dhe do ta sigurojë atë që të realizohet sipas kushteve të përcaktuara dhe kuadrin e kontraktuar.** Prandaj, burimet financiare të planifikuara për angazhimin e mbikëqyrjes profesionale duhet të jenë adekuate/të mjaftueshme për të siguruar cilësi në realizimin e projektit infrastrukturor, veçanërisht për shkak të faktit se lëshimet eventuale në këtë fazë më vonë mund të shkaktojnë pasoja shumë më të mëdha financiare. Në këtë kuptim, rekomandohet për angazhimin e mbikëqyrjes profesionale në mënyrë indikative të planifikohet 5-10% të vlerës së projektit infrastrukturor. Në vazhdim jepen rekomandime të tjera praktike se si të zbatohet procesi i mbikëqyrjes në mënyrën më të mirë të mundshme.

Mbi të gjitha, është me rëndësi të merret parasysh profesionalizmi dhe përvoja e mëparshme e personave që ushtrojnë mbikëqyrje profesionale. Një pjesë e përvojës së deritanishme flet për avantazhin nëse mbikëqyrja profesionale kryhet nga persona të zonës së komunitetin lokal apo rajonit ku zbatohet

projekti i infrastrukturës (praktika në disa raste ka treguar se ekspertët vendas janë shumë më të pranishëm në kantierin e ndërtimit, gjë që ka një rëndësi të madhe si për investitorin, ashtu edhe për kontraktorin).

Autoriteti mbikëqyrës duhet të jetë i pranishëm vazhdimisht në kantierin e ndërtimit, ta njohë mirë legjislacionin, dokumentacionin teknik dhe kontratën mbi bazën e së cilës kryhen punimet, si dhe aktet normative nënligjore teknike dhe të ndërtimit. Nga ana tjetër, takime të rregullta duhet të zhvillohen edhe me përfaqësues të ekipit të projektit dhe kontraktorit, si dhe të mbahen procesverbale për të njëjtat, duke monitoruar vazhdimisht cilësinë e punimeve të kryera dhe materialeve të instaluara, dhe veçanërisht të monitorohen të gjitha punët nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe që **autoriteti i angazhuar mbikëqyrës rregullisht t'i informojë palët e interesuara, mbi të gjitha ekipin e projektit që menaxhon projektin e infrastrukturës dhe përfaqëson interesat e vetëqeverisjes lokale si një autoritet kontraktor**. Zakonisht, bëhen raporte të shkurtra javore që e monitorojnë përparimin e kantierit të ndërtimit dhe që mbështeten nga dokumentacioni fotografik, por duhen bërë edhe raporte të detajuara mujore dhe ta përfshijnë të gjithë volumin e punës. Raporti mujor duhet domosdoshmërisht të përmbajë informacione bazike në lidhje me investitorin, kontratën e vlefshme, anekset dhe kontraktorin, me fokus mbi periudhën në fjalë. Përveç kësaj, mbikëqyrja duhet të japë informacione edhe mbi këto si vijon:

- Përshkrimin e punëve të kryera gjatë periudhës së caktuar;
- Çështjet që mund të ndikojnë mbi afatet e realizimit;
- Listën e punëve të përfunduara;
- Të dhënat për punët e bëra mirë, si dhe për tepricat e punës, shkurtesat e punës dhe për punët e paparashikuara;
- Arsyet e devijimit nga punët e parashikuara;
- Rekomandimet për shmangien e mangësive dhe masat e mundshme të shmangies;
- Mjetet e nevojshme për realizimin e mëtejshëm;
- Aktivitetet e prapambetura me vlerësimin e kohës së nevojshme për të përfunduar;
- Foto dokumentacionin.

Veç tjerash, është me rëndësi që **pas përfundimit të plotë të punimeve dhe kontrollit të kryer teknik, autoriteti mbikëqyrës të hartojë një raport**

kumulativ (final) që duhet të përfshijë ç'do gjë që ka ndodhur në kantierin e ndërtimit gjatë realizimit të projektit. Raporti përfundimtar duhet të përmbajë informacione për kontratën dhe anekset e kontratës, kontraktorin dhe personin përgjegjës të kantierit, lejen e ndërtimit, dokumentacionin teknik mbi bazën e të cilit është ndërtuar objekti, periudhën e realizimit të punimeve, informacione të detajuara për ndryshimet e projektit dhe pëlqimet e projektuesit, tepricat dhe shkurtesat, si dhe punët e paparashikuara që janë shfaqur gjatë realizimit, detajet e realizimit të punimeve (p.sh. gjatësia e tubacionit, numri i stacioneve të pompimit, karakteristikat e pompës, sipërfaqja e objektit etj.), cilësinë e punimeve të realizuara, dokumentacionin e siguruar gjatë kryerjes së punimeve dhe për lejen e lëshuar të përdorimit. Kjo mënyrë e përshkrimit do të sigurojë se të gjitha informacionet e rëndësishme për realizimin e projektit infrastrukturor janë në një vend.

Mënyra e kryerjes së kontrollit teknik dhe përmbajtja e raportit janë rregulluar me rregulloret si vijon:

- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e raportit për kontrollin e kryer teknik nga inxhinieri mbikëqyrës **për ndërtime të kategorisë së dytë** me shtojcën-raport për kontrollin e kryer teknik (Gazeta Zyrtare e RSM-së nr. 13/13); dhe
- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së kontrollit teknik (Gazeta Zyrtare e RSM-së nr. 24/11, nr. 60/13)[1].

Aspekti i tretë i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë së punëve të kryera dhe pajisjeve të instaluara është komunikimi dhe koordinimi i rregullt i aktiviteteve midis ekipit të projektit dhe autoritetit të angazhuar mbikëqyrës dhe organizimi i procedurës së mbikëqyrjes. Gjatë realizimit të projekteve infrastrukturore, është jashtëzakonisht e rëndësishme që anëtarët e ekipit të projektit (përfaqësues të shërbimeve kompetente të Vetëqeverisjes Lokale dhe ndërmarrjeve komunale) rregullisht ta vizitojnë terrenin, të mbajnë takime me autoritetin mbikëqyrës dhe kontraktorin (në nivel javor) dhe të kenë këqyrje të vazhdueshme në zhvillimin e situatës dhe dinamikën e realizimit të punimeve. Në përputhje me dokumentacionin teknik dhe projektin bazë, nevojitet qysh në fillim, në një takim të përbashkët, të përcaktohen komponentët kritikë të projektit, të cilët nuk mundet dhe nuk guxon të fillojë përpara se autoriteti mbikëqyrës të vizitojë lokacionin dhe të japë dritë jeshile" për vazhdimin e aktiviteteve.

1 Të gjitha format janë të aksesshme në linkun si vijon: https://www.slvesnik.com.mk/besplaten-pristap-do-izdanija.nspx

4.3. Lidhja e kontratave sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta në librat FIDIC

Në procesin e realizimit të projekteve infrastrukturore, një hap shumë i rëndësishëm është vetë zgjedhja e ekspertëve, konsulentëve dhe inxhinierëve, të cilët, në emër të organeve kompetente të komunës, duhet të përgatisin dokumentacionin cilësor për zbatimin e procedurës së tenderit, që duhet të përfundojë me lidhjen e kontratës për prokurimin publik të punëve.

Për këtë qëllim, shpesh përdoren kontrata dhe dokumente sipas të ashtuquajturit model FIDIC.

FIDIC është një shkurtesë e Shoqatës Ndërkombëtare të Inxhinierëve Konsulentë (Fédération internationale des ingénieurs-conseils) në kuadër të së cilës janë zhvilluar një sërë mekanizmash, dokumente dhe procedura praktike që mund të ndihmojnë gjatë realizimit të projekteve të ndryshme të ndërtimit dhe infrastrukturore.

Librat apo modelet e FIDIC janë modele standarde të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta kontraktore që përdoren më së shpeshti për të përcaktuar marrëdhënien midis porositësit dhe kontraktorit. Ekzistojnë disa lloje të modeleve të kontratave dhe ato përdoren në varësi të llojit të projektit, punëve që janë objekt të kontratës dhe kapacitetit të bartësit të projektit. Këtu duhet theksuar se kushtet e kontratave të FIDIC vetvetiu nuk janë të përdorshme, pasi ato janë modele tipike me kushte të inkorporuara të përgjithshme dhe të veçanta dhe me specifikime të caktuara teknike, të cilat pastaj duhet t'u përshtaten nevojave të porositësit të projektit dhe kontraktorit. Kushtet e kontratave të FIDIC në mënyrë plotësuese përshtaten terminologjikisht, përkatësisht harmonizohen me nocionet dhe dispozitat e legjislacionit kombëtar, me zakonet afariste vendore dhe me kërkesa të tjera specifike. Në praktikën afariste, ato përdoren shpesh, sepse tregu i ka identifikuar si të dobishme kushtet e përcaktuara në kontratat e FIDIC. Mes tjerash, modelet e kontratave FIDIC konsiderohen si:

- Relativisht mirë të balancuara, me një ndarje korrekte të të drejtave dhe detyrimeve midis palëve kontraktore;
- Të dëshmuara, sepse ka shembuj të shumtë se ato në të kaluarën janë përdorur gjatë përgatitjes së kontratave;
- Të pranuara – botërisht të njohura, emblematike, ndërkaq përdoren për lidhjen e traktateve ndërkombëtare;
- Gëzojnë mbështetje - të rekomanduara dhe shpesh të kërkuara nga institucionet financiare ndërkombëtare;
- Efektive, të qarta dhe me dispozita më se të nevojshme, të cilat i përbëjnë kushtet e kontratës.

Tashmë është e njohur se ka disa libra të ndryshëm të FIDIC dhe modele të kontratave. Ato emërtohen sipas ngjyrës së kopertinave dhe më së shpeshti përdoren libri "i kuq", "i verdhë", "i argjend" dhe "i gjelbër". Çdo dhjetë vjet FIDIC boton një edicion të ri të rishikuar të kushteve kontraktore:

- Kushtet e kontratës për ndërtim - FIDIC i Kuq;
- Kushtet e kontratës për impiante, projektimin dhe ndërtimin sipas sistemit "projekto-ndërto" - FIDIC i Verdhë;
- Kushtet e kontratës sipas sistemit "me çelës në dorë" - FIDIC i Argjend;
- Forma e shkurtër e kontratës - FIDIC i Gjelbër.

FIDIC i Kuq ka të bëjë me kushtet kontraktore për kryerjen e punimeve të ndërtimit, konform projektit të porositësit (projekti i punimeve të ndërtimit është përpiluar nga porositësi ose nga një kompani e licencuar projektuese).

FIDIC i Verdhë përdoret në kontratat për impiante, projektim dhe ndërtim sipas sistemit "projekto-ndërto" (zakonisht për pajisjen me pajisje elektrike dhe/ose makineri dhe për projektimin ose kryerjen e punimeve të ndërtimit për ndërtime të larta dhe të ulëta së bashku me projektimin). FIDIC i Verdhë është karakteristik me atë që kontraktori merr përsipër një pjesë të detyrimeve të projektimit dhe ndërtimit, në përputhje me kërkesat e porositësit, gjë që e bën atë mjaft specifik nga këndvështrimi i legjislacionit kombëtar me ç'rast funksioni i projektimit është qartësisht i ndarë nga realizimi i punimeve.

FIDIC i Argjend është parashikuar për situatat në të cilat një subjekt plotësisht e merr përgjegjësinë për projektimin dhe realizimin e ndërhyrjes së përgjithshme. Me fjalë të tjera, subjekti e bën projektimin e plotë, prokurimin dhe ndërtimin në mënyrë që rezultati të jetë një fabrikë plotësisht e pajisur gati për përdorim (operim).

FIDIC i Gjelbër është i dedikuar për punime ndërtimi me volum dhe vlerë më të ulët, por mund të përdoret edhe për punime me vlerë më të lartë, veçanërisht për punë relativisht të thjeshta përsëritëse ose për punë afatshkurtra.

Karakteristikat e mësipërme të kushteve FIDIC (me përjashtim të formës së shkurtër) tregojnë se klasifikimi i tyre varet nga ajo se cila palë kontraktore e përgatit dhe është përgjegjëse për hartimin e pjesës më të madhe të dokumentacionit të projektit. Kryesisht "libri i kuq" dhe "libri i verdhë" janë librat që përdoren në varësi të llojit të punëve, me ç'rast kur vendoset se cili model do të përdoret, detyrimisht duhet të merret parasysh edhe respektimi i legjislacionit kombëtar. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit për prokurimin e shërbimeve për mbikëqyrje profesionale, mund të përdoret edhe "libri i bardhë" i FIDIC ose ndonjë model tjetër.

Pavarësisht strukturës organizative në dukje komplekse, dokumentacionit vëllimor kontraktual dhe numrit të madh të dokumenteve që përpilohen gjatë zbatimit të kontratave bazuar në kushtet e FIDIC, megjithatë me zbatimin e tyre arrihet standardizimi i punëve dhe paraprakisht dihet shpërndarja e të drejtave, detyrimeve dhe rreziqeve.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, deri më tani, më së shpeshti përdoret libri "i kuq" dhe "i verdhë" për projektet infrastrukturore në sektorin e mjedisit/ekologjisë, edhe atë kryesisht tek prokurimet e financuara me fonde të huaja, si dhe tek kontratat koncesionare dhe PPP.

Në tregjet e zhvilluara ku zbatohen më shpesh kushtet e FIDIC, vetëm duke i përmendur ato, palët e interesuara e dinë saktësisht se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktore, pa pasur nevojë për elaborim të hollësishëm.

4.4. PRAG si udhëzues i procedurave për lidhjen e kontratave dhe prokurime

Për projektet që (bashkë)financohen nga fondet e Bashkimit Evropian, është e domosdoshme të njihen procedurat për lidhjen e kontratave të përcaktuara nga PRAG - udhëzues praktik i procedurave në lidhje me kontratat e veprimit të jashtëm të Bashkimit Evropian (ang. PRAG - Practical Guide to Contract procedures for EU external actions2). Duhet të kihet parasysh se procedurat e PRAG zbatohen për të gjitha kontratat që janë pjesë e asistencës së BE-së për vendet e treta, duke përfshirë projektet e financuara nga fondet e para-anëtarësimit, në vend të legjislacionit kombëtare të prokurimeve publike të vendeve - përfituese. PRAG përcakton rregulla strikte për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve ndërkaq i shpjegon procedurat për lidhjen e kontratave kur përdoren fondet e BE-së.

Sipas dispozitave të PRAG, ekzistojnë tri lloje kryesore të kontratave:

- Kontrata për sigurimin e shërbimeve;
- Kontrata për prokurimin e mallrave;
- Kontrata për realizimin e punimeve.

Kontratat e sigurimit të shërbimeve përdoren për prokurimin e shërbimeve, të tilla si sigurimi, marrja me qira e pajisjeve dhe automjeteve, kontabiliteti, hulumtimi i tregut dhe hulumtimet statistikore, shërbimet sanitare, shërbimet e konsulencës, arsimi, pastrimi, shërbimet hoteliere, mbrojtja e objekteve, shërbi-

2 Versioni 2021.1, i vlefshëm nga data 24 qershor 2022, i aksesshëm në https://wikis.ec.europa.eu/display/ExactExternalWiki/ePRAG

met promovuese, organizimi i ekspozitave dhe takimeve, emisionet dhe publikimet, zhvillimi profesional, zhvillimi i softuerit dhe zhvillimi i faqes së internetit, monitorimi dhe evaluimi, auditimi, studimet para-fizibilitetit dhe fizibilitetit, asistenca teknike, projektet arkitektonike/ndërtimore, mbikëqyrja e punimeve, etj.

Në kuadër të kontratave për sigurimin e shërbimeve ekzistojnë lloje specifike të kontratave, siç janë kontratat për hartimin e studimeve ku përcaktohet rezultati përfundimtar që duhet të arrihet, përkatësisht kontraktori doemos duhet të livrojë një produkt të caktuar, ndërsa mjetet teknike dhe operacionale me të cilat e arrin rezultatin e përcaktuar janë të parëndësishme. Bëhet fjalë për kontrata paushall ndërkaq kontraktori do të paguhet vetëm nëse arrin një rezultat të caktuar.

Kontratat e prokurimit të mallrave i referohen blerjes së të gjitha llojeve të mallrave: pajisje, makina, produkte bujqësore, automjete, softuer, mobilie zyre, material zyre dhe material harxhues, karburant, pajisje kompjuterike, pjesë këmbimi, etj. Ato mund të përfshijnë edhe shërbime që lidhen drejtpërdrejt me mallrat, të tilla si transporti dhe livrimi, instalimi i pajisjeve dhe trajnimi i përdoruesve për manipulimin me pajisjet e blera, mirëmbajtjen, riparimet dhe shërbimet pas shitjes.

Kontratat për realizimin e punimeve i referohen realizimit dhe/ose projektimit dhe realizimit të punimeve. Ato përfshijnë ndërtimin ose riparimin e pikave të ngarkim-shkarkimit, deponive, impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, rregullimin e ndërtesave, hangarëve, depove, akumulimeve, rrugëve, urave, instalacioneve, rrjeteve të komunikimit dhe linjave të tensionit të lartë, si dhe punimeve që lidhen me përgatitjen e kantiereve dhe materialeve të ndërtimit, rregullimin e mjedisit jetësor dhe punë të ngjashme të ndërtimit.

Kur bëhet fjalë për projekte infrastrukturore në fushën e mjedisit jetësor, për shumicën e tyre relevante janë pikërisht kontratat për realizimin e punimeve. Për secilën nga llojet e listuara të kontratave të PRAG janë përcaktuar procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me:

- procedurën e pjesëmarrjes në tender;
- përgatitjen e dokumentacionit të tenderit;
- shpalljen e tenderëve;
- krijimin e komisionit për evaluimin e ofertave;
- procedurën e përzgjedhjes së ofertës/anulimit të procedurës;
- procedurën e përgatitjes dhe nënshkrimit të kontratës.

Kur bëhet fjalë për vetë procedurën e tenderit, në veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian, mund të jetë:

- Procedura e kufizuar (restricted procedure);
- Procedura e hapur (open procedure);
- Procedura e hapur lokale (local open procedure);
- Procedura e thjeshtuar (simplified procedure)

Tabela:

Procedurat standarde të akordimit të kontratave dhe vlerës së kontratave sipas PRAG

<table>
<tr><td>Услуги</td><td>≥ 300.00 €
● Procedura ndërkombëtare e kufizuar ose e hapur e tenderit</td><td colspan="2">≤ 999.9999 €
● Marrëveshja kuadër (SIEA 2018), ngjarje 2020
< 300.000 €
● Kontratat kuadër (Events 2020)
● Procedura e thjeshtuar</td><td rowspan="3">≤ 20.000 €
● Një ofertë
≤ 2.500 €
● Pagesa në bazë të faturës pa tender</td></tr>
<tr><td>Стоки</td><td>≥ 300.000 €
● Procedura ndërkombëtare e kufizuar ose e hapur e tenderit</td><td>< 300.000 €, но ≥ 100.000 €
● Procedura e hapur lokale e tenderita</td><td>< 100.000 €, por >20.000 €
● Procedura e thjeshtuar</td></tr>
<tr><td>Работи</td><td>≥ 5.000.000 €
● Procedura ndërkombëtare e hapur e tenderit ose
● Procedura ndërkombëtare e kufizuar e tenderit</td><td>< 5.000.000 €, но ≥ 300.000 €
● Procedura e hapur lokale e tenderit</td><td>< 300.000 €, но >20.000 €
● Procedura e thjeshtuar</td></tr>
</table>

LITERATURA E PËRDORUR

Broshura e Planifikimit të Prokurimeve Publike – Byroja e Prokurimeve Publike - Shkup, 2020

Udhëzuesi Praktik i Prokurimeve Publike, Shkup 2019.

Manuali për Monitorimin dhe Kontrollin e Justifikimit të Prokurimeve Publike, Beograd 2016

Udhëzuesi Praktik i Procedurave të Përfundimit të Marrëveshjeve të Asistencës së Komunitetit Evropian me Vendet e Treta (Prag) - Përmbledhje e Prokurimit Publik Nr. 38 me titull “Ndryshimet e Kontratës” nga SIGMA

Manuali për Menaxhimin e Projekteve të Mëdha Infrastrukturore – publikimi i vitit 2016

Raporti për Flamujt e Kuq dhe Bazën e të Dhënave të Hapura SEPP

ANEKSI

ANEKSI 1

1. Indikatori – Ndryshimi i PVPP

	Numri i proce-durave	Numri i proce-durave të reja për prokurimet e papara-shikuara të PVPP fillestar	rocedura të reja në %
Publikimi i parë i PVPP	80	40	50
Versioni i fundit i PVPP	120		

Burimi i të dhënave: SEPP - PVPP

2. Indikatori – Ndryshimi i vlerës së vlerësuar të PP

	Numri i shpalljev	% e shpalljeve me vlerë të vlerësuar të ndryshuar
Gjithsej shpallje	100	4
Shpallje me vlerë të vlerë-suar të ndryshuar	4	

Burimi i të dhënave: SEPP - Dosja e procedurës (vendimi për plotësimin e mjeteve) ose njoftimi për kontratë të lidhur.

Tabela

Numri rendor	Shpallja numër	Vlera fillestare	VF e ndryshuar	% e ndryshimit të vlerës fillestare	Arsyeja e ndryshimit
1	21/2023	150.000,00	200.000,00	33,33	çmimet më të larta të tregut
2	22/2023	200.000,00	220.000,00	10,00	VF joreale
3	23/2023	500.000,00	515.000,00	3,00	VF joreale
4	24/2023	5.000.000,00	5.500.000,00	10,00	çmimet më të larta të tregut
5		0,00	0,00	/	

Burimi i të dhënave: SEPP - Dosja e procedurës (Vendimi për prokurimin publik, Vendimi për plotësimin e mjeteve ose Njoftimi për kontratë të lidhur).

3. Indikatori – autoriteti kontraktor nuk e ka respektuar afatin e vendimit

	Numri i proce-durave	% e procedurave me afat të skaduar për vendim-marrje
Procedura të evaluara	100	2
Procedura me afat të skaduar për vendim-marrje	2	

Burimi i të dhënave: SEPP - të dhënat e vendimeve më të fundit.

Tabela e procedurave të evaluara

Numri rendor	Lloji i procedurës	Numri i shpalljes	Data e publikimit	Afati i fundit për paraqitjen e Ofertës	Afati ligjor për Vendim-marrje	Data e Vendim-marrjes	Diferenca në ditë	Nr.rend. i procedurave me afat të skaduar
1	ОП	23/2023	01.02.2023	03.03.2023	03.04.2023	03.06.2023	60	1
2	ПОП	24/2023	01.02.2023	17.02.2023	04.03.2023	04.03.2023	0	
3	НМВ	25/2023	01.02.2023	09.02.2023	16.02.2023	16.02.2023	0	
4	ПОП	24/2023	01.02.2023	17.02.2023	04.03.2023	04.04.2023	30	2
5								
6								
7								
8								
9								
10								

* Shënim. Në tabelë shënohen të dhëna me afat të skaduar.

4. Indikatori – Numri mesatar i ofertave, pjesëmarrja në procedurat konkurruese, përfaqësimi i kontratave me 1 ofertë

INDIKATORËT / KRAHASIMI			autoriteti kontraktor (komuna)	komuna të tjera në rmv(vlera mesatare)
vlera mesatare e kontratave		prokurimi me vlerë të vogël		
		procedura e hapur e thjeshtuar		
		procedura e hapur		
		gjithsej	0	0
procedurat konkurruese	procedura e hapur	sipas numrit		
	пол	sipas numrit		
	prokurime me vlerë të vogël	sipas numrit		
		gjithsej	0	0
procedurat jokonkurruese	procedurë me negociata pa publikimin e shpalljes	sipas numrit		
epilogu i procedurave		të suksesshme(kontrata të lidhura)		/
		të prolonguara (procedura që nuk kanë filluar)		
		pjesë e anuluar		
		tërësisht të anuluara		
numri mesatar i ofertave				/
kontrata me 1 ofertë				

5. Indikatori – Shpërndarja e prokurimeve publike komunale deti te operatorët ekonomikë

	Numri i kontratave	Vlera e përgjithshme e kontratave të akorduara	% pjesëmarrja e kontratave që u janë akorduara OE në vlerën e përgjithshme të kontratave të AK
EO 1	10	100.000,00	0,73
EO 2	8	1.000.000,00	7,30
EO 3	9	1.500.000,00	10,95
EO 4	3	800.000,00	5,84
EO 5	6	300.000,00	2,19
EO 6	7	10.000.000,00	72,99
Gjithsej	43	13.700.000,00	100,00

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP - njoftimi për kontratën e lidhur dhe të dhënat tremujore.

6. Indikatori – Integrimi gjinor i kontratave të lidhura të prokurimeve publike

Vlera e përgjithshme e kontratave të lidhura të PP në nivel të komunë	Numri i kontratave të akorduara tek OE të menaxhuar nga gratë	Vlera e përgjithshme e kontratave të akorduara të menaxhuara nga gratë	% e pjesëmarrjes së kontratave të akorduara tek OE të menaxhuar nga gratë në vlerën e përgjithshme të kontratave të AK

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP -njoftimi për kontratën e lidhur dhe të dhënat tremujore.

7. Indikatori – Procedurat e anuluara të prokurimeve publike

	Numri i procedurave të komunës	%	Numri mesatar i procedurave të të gjitha komunave në RMV	%
Procedura të publikuara	62	100	200	100
Procedura të anuluara	21	33,87	30	15,00
Nuk është paraqitur asnjë ofertë apo asnjë ofertë e pranueshm	8	38,10	12	40,00
Është vlerësuar se DT përmban lëshime ose mangësi të rëndësishme	6	28,57	8	26,67
Për shkak të rrethanave të paparashikuara dhe objektive, nevojat e AK janë ndryshuar	7	33,33	10	33,33

Burimi i të dhënave: SEPP - Të dhëna të hapura

* Vlera mesatare e treguesit në nivel të të gjitha komunave fitohet përmes selektimit të të gjitha komunave në SEPP në pjesën „Të dhëna transparente“ ndërkaq përpjestohet me numrin e komunave të selektuara.

8. Indikatori – Mospërputhja midis kontratave të planifikuara, të lidhura dhe të realizuara të PP

	Nr. i përg-jith-shëm	%	Përmbajtja e shpall-jeve dhe DT		Përmbajtja e ndry-shimeve të DT dhe informacionet sht-esë		Evaluimi i ofertave dhe arsyet e anu-limit të procedurës	
			6poj	%	6poj	%	6poj	%
Procedura	150	100						
Procedura të ankimuara	30	20	14	46,67	14	46,67	2	6,67
Ankesa të aprovuara	14	9,3333	7	23,33	6	20,00	1	3,33
Ankesa të refuzuara	16	10,667	7	23,33	8	26,67	1	3,33

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP.

9. Indikatori – Procedurat e ankimuara të prokurimeve publike

	Vlera	**%**
Procedura të planifikuara	100.000.000,00	100,00
Kontrata të lidhura	90.000.000,00	90,00
Kontrata të realizuara	80.000.000,00	80,00
Mjete të pashfrytëzuara	20.000.000,00	20,00

ANEKSI 2

Ky Aneks e përmban arsyetimin e kuptimit të secilit indikator të propozuar veç e veç ndërkaq janë prezantuar edhe elementet e nevojshme hyrëse si dhe mënyra me të cilën u fitua rezultati për secilin indikator.

1. Indikatori – Ndryshimi i PVPP

Përqindja e madhe e ndryshimeve të PVPP ka të bëjë me indikatorin e menaxhimit të keq dhe jo në kohën e duhur të nevojave në nivel komunal. Ndryshimet e shpeshta të planit e ulin besimin e OE dhe publikut, tregojnë elemente të mundshme korruptive dhe subjektive të nevojës së prokurimit i cili paraprakisht nuk është planifikuar.

Elementet hyrëse:

- Numri i procedurave të përfshira në publikimin fillestar të PVPP
- Numri i procedurave të përfshira në versionin e fundit të PVPP

Indikatorët dalës:

Numri i procedurave të reja të prokurimeve që nuk ishin parashikuar në publikimin fillestare të PVPP (në numër dhe %) = (numri i përgjithshëm i procedurave nga versioni i fundit i planit/numri i përgjithshëm i procedurave nga publikimi fillestar i planit x 100-100).

Burimi i të dhënave: ECJH- ГПЈН.

Shtojca: Tabela 3a Indikatori 1

2. Indikatori – Ndryshimi i vlerës së vlerësuar të PP

Ndryshimi i vlerës së vlerësuar përpara se të zgjidhet ofertuesi më i favorshëm me të cilin do të lidhet kontrata është rezultat i veprimit të keq dhe josistematik të autoritetit kontraktor gjatë përcaktimit të vlerës së vlerësuar të prokurimit në planin e prokurimeve dhe në vendimin për prokurimin publik. Më së shpeshti kjo është rezultat i analizës së parealizuar të tregut që duhet ta kontrollojë realitetin e vlerës së vlerësuar.

Elementet hyrëse:

- Numri i përgjithshëm i shpalljeve
- Numri i shpalljeve me vlerë të vlerësuar të ndryshuar
- Indikatorët dalës:
- % e shpalljeve me vlerë të vlerësuar të ndryshuar (numri i shpalljeve me vlerë të vlerësuar të ndryshuar/numri i përgjithshëm i shpalljeve x 100)

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP.

Shtojca: Tabela e indikatorit 2

3. Indikatori – autoriteti kontraktor nuk e ka respektuar afatin e vendimit

Ky indikator tregon se në sa nga procedurat e publikuara të prokurimeve, autoriteti kontraktor nuk e ka respektuar afatin e vendimit të përcaktuar në nenin 112 paragrafi 2 të LPP, pavarësisht ekzistencës së dispozitave kundërvajtëse për një veprim të këtillë.

Elementet hyrëse:

- Numri i përgjithshëm i procedurave të evaluara
- Numri i përgjithshëm i procedurave me afat të skaduar për vendim-marrje

Indikatorët dalës:

- % e procedurave me afat të skaduar për vendim-marrje (numri i përgjithshëm i procedurave me afat të skaduar/numri i përgjithshëm i procedurave të evaluara x 100)

Burimi i të dhënave: SEPP - të dhëna nga vendimet më të fundit.

Shtojca: Tabela e indikatorit 3

- Tabela e numrit mesatar të procedurave me afat të skaduar
- Tabela ndihmëse e procedurave të evaluara

4. Indikatori – Numri mesatar i ofertave, pjesëmarrja në procedurat konkurruese, përfaqësimi i kontratave me 1 ofertë

Indikatorët:

- Vlera mesatare e kontratave (në MKD) = (vlera e përgjithshme e kontratave/ numri i kontratave)
- Procedurë e hapur/Procedurë e hapur e thjeshtuar/Prokurim me vlerë të vogël, sipas numrit dhe vlerës (në %)
- Procedurat konkurruese/jo-konkurruese, sipas numrit dhe vlerës (në %)
- Rezultati i procedurave (në %), si vijon: pjesë të suksesshme, të pashpalluara, të anuluara, të anuluara plotësisht
- Numri mesatar i ofertave
- Kontratat me 1 ofertë (në % nga shpalljet e evaluara në përgjithësi)

Indikatorët e komunës krahasohen me vlerën mesatare të indikatorëve të njëjtë në nivel të të gjitha komunave në RMV me qëllim të identifikimit të devijimeve dhe për të kontrolluar rastet e këtilla me qëllim të zgjidhjes së dobësive të identifikuara.

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP.

Shtojca: Tabela e indikatorit 4

5. Indikatori – Shpërndarja e prokurimeve publike komunale operatorëve ekonomikë

Ky indikator e tregon proporcionin e shpërndarjes së Buxhetit komunal të dedikuar për prokurimet publike ndërmjet operatorëve ekonomikë me të cilët komuna ka lidhur kontrata.

Elementet hyrëse:

- Numri i kontratave që u akordohen operatorëve ekonomikë (veç e veç për çdo OE)
- Vlera e përgjithshme e kontratave që u akordohen operatorëve ekonomikë (veç e veç për çdo OE)

Indikatorët dalës (në formën e grafikut):

- % e pjesëmarrjes së kontratave që u akordohen operatorëve ekonomikë në raport me vlerën e përgjithshme të kontratave të lidhura të OK (vlera e kontratave të akorduara për OE/vlera në total e të gjitha kontratave për PP në nivel të AK x 100)

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP - Njoftime për kontratën e lidhur dhe të dhënat tremujore.

Shtojca: Tabela e indikatorit 5

6. Indikatori – Integrimi gjinor në kontratat e lidhura për prokurime publike

Ky indikator e tregon pjesëmarrjen kontratave të akorduara për OE të menaxhuara nga gratë në raport me vlerën e përgjithshme të kontratave të lidhura në nivel komunal..

Elementet hyrëse:

- Vlera e përgjithshme e kontratave të lidhura për PP në nivel të komunës
- Numri i kontratave të akorduara për OE të menaxhuara nga gratë

Indikatorët dalës (në formën e grafikut):

- % e pjesëmarrjes së kontratave të akorduara për OE të menaxhuara nga gratë në vlerën e përgjithshme të kontratave të komunës (vlera e kontratave të akorduara për OE të menaxhuara nga gratë/vlera e përgjithshme e të gjitha kontratave për PP në nivel të komunës x 100)

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP – Njoftime për kontratën e lidhur dhe të dhënat tremujore.

Shtojca:Tabela e indikatorit 6

7. Indikatori – Procedurat e anuluara të prokurimeve publike

Ky indikator tregon se sa nga procedurat e publikuara përfundojnë pa sukses, respektivisht me anulim, ndërsa arsyeja e anulimit është tregues i dobësive të cilat autoriteti kontraktor duhet t'i tejkalojë.

Indikatorët:

- Numri i procedurave të publikuara
- Numri i procedurave të anuluara
- Arsyeja e anulimit:
  - nuk është paraqitur asnjë ofertë apo asnjë ofertë e pranueshme (në %),
  - është vlerësuar se DT përmban lëshime ose mangësi të rëndësishme (në %),
  - për shkak të rrethanave të paparashikuara dhe objektive, nevojat e AK janë ndryshuar (në %).

Indikatorët e komunës krahasohen me vlerën mesatare të indikatorëve të njëjtë në nivel të të gjitha komunave në RMV me qëllim të identifikimit të devijimeve dhe për të kontrolluar rastet e këtilla me synimin e zgjidhjes së dobësive të identifikuara.

Burimi i të dhënave: Dosja e procedurave dhe SEPP.

Shtojca: Tabela e indikatorit 7

8. Indikatori – Procedurat e ankimuara të prokurimeve publike

Ky indikator tregon se sa nga procedurat e publikuara ankimohen, ndërsa arsyeja e anulimit është tregues i dobësive që autoriteti kontraktor duhet ti tejkalojë.

Elementet hyrëse:

- Numri i përgjithshëm i procedurave
- Numri i procedurave të ankimuara
- Numri i ankesave të aprovuara
- Numri i ankesave të refuzuara

Indikatorët dalës:

- Pjesëmarrja e procedurave të ankimuara në numrin e përgjithshëm të procedurave (në %)
- Baza ligjore e paraqitjes së ankesës në raport me numrin e përgjithshëm të procedurave të ankimuara:
  - përmbajtja e shpalljes dhe DT (në %)
  - përmbajtja e ndryshimeve të DT dhe informacionet shtesë (në %)
  - evaluimi i ofertave dhe arsyet e anulimit të procedurës (në %)

- Ankesa të bazuara (të aprovuara) (numri i përgjithshëm i ankesave të aprovuara/numri i përgjithshëm i ankesave x 100)
- Ankesa të pabazuara (të refuzuara) (numri i përgjithshëm i ankesave të refuzuara/numri i përgjithshëm i ankesave x 100)

Në bazë të indikatorëve të fituar dalës, komuna mund të ketë këqyrje mbi vëllimin e procedurave të ankimuara dhe bazën më të shpeshtë ligjore të ankimimit të procedurave, në mënyrë që t'i tejkalojë dobësitë e detektuara.

Burimi i të dhënave: SEPP – Të dhëna nga E-ankesa.

Shtojca: Tabela e indikatorit 8

9. Indikatori – Mospërputhja midis kontratave të planifikuara, të lidhura dhe të realizuara për PP

Elementet hyrëse:

- Vlera e procedurave të planifikuara të PP (PVPP)
- Vlera e kontratave të lidhura
- Vlera e kontratave të realizuara

Indikatorët dalës:

- përmbushja e PVPP (në %) = (vlera e kontratave të lidhura/vlera e PVPP x 100)
- realizimi i kontratave të lidhura të PP (në %) = (vlera e kontratave të realizuara/vlera e kontratave të lidhura x 100)
- mjetet e parealizuara të PP të planifikuara në Buxhetin e komunës (në %) = (Vlera e kontratave të realizuara/vlera e PVPP x 100)

Burimi i të dhënave: PVPP, Buxheti i komunës dhe SEPP.

REZYME: Treguesi e mundëson vlerësimin e përputhshmërisë midis kontratave të planifikuara, të lidhura dhe të realizuara në nivel komunal, përkatësisht se a ka devijime të caktuara dhe si të njëjtat të tejkalohen në të ardhmen.

	SPECIFIKIMI I MATERIALIT TË ZYRËS - PRODUKTEVE TË LETRËS (KONTRATA. NR.											
Ред. бр.	Përshkrimi i materialit të zyrës	Njësia matëse	Sasia	Çmimi pa TVSH	Gjithsej pa TVSH	Sasi të prokuruara sipas faturës nr.	Çmimi i përgjithshëm pa TVSH sipas faturës nr	Sasi të tjera sipas kontratës	Sasi të prokuruara sipas faturës nr.	Вкупна цена без ДДВ по ф-ра бр.	Çmimi i përgjithshëm pa TVSH sipas faturës nr	Vonesa gjatë prokurimeve (në ditë)
1	2	3	4	5	6	7	8 (7x5)	9 (4-7)	10	11 (10x5)	12 (9-10)	13
1	Letër për fotokopje e bardhë, A4 , minimum 1/500, 80g/м2	top	300	340,00	102.000,00	140	47.600,00	160	30	10200	130	
2	Letër Double e bardhë, A3, 80g. me minimum 1/250 fletë	top	10	450,00	4.500,00	2	900	8		0	8	
3	Fletore me kapakë të butë me vija të gjëra, A4, me minimum 50 fletë	copë	5	75,00	375,00		0	5		0	5	
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												
11												
12												
13												
14												
15												
GJITHSEJ					106.875,00	48.500,00		10.200,00				
TVSH												
GJITHSEJ ME TVSH					106.875	48.500		10.200				
SASIA E MBETUR SIPAS KONTRATËS						58.375		48.175				